

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7751 E premte 28 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

Dhjetori shënoi katër momente të rëndësishme për politikën dhe diplomacinë greke në planin Euro-Atlantik dhe rajonal. Më 13 dhjetor, bashkë ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Dy fjalë për katër lëvizje diplomatike greke




**Opinion** *i* **Ditës**

Më shumë kënaqësi e pranovafitesën për të marrë pjesë në këtë simpozium, që vlerëson dhe nderon jetën e veprën e intelektualit dhe shkrimtarit ...  
Vijon në faqen 21

Nga ILIR META

Sterjo Spasse - Një dhe i pandarë



Kush ishte 17-vjeçarja Briselda Gjikota

## Atentati në makinë për një shuplakë, pse u qëlluan dy të rinjtë në Laprakë

Erion Bengo u konfliktua me të riun nga Puka një javë para krimit. Mesazhi prekës i vëllait

Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Laprakë, ku mbeti e vrarë 17-vjeçarja Briselda Gjikota dhe u plagos rëndë i dashuri i saj, Erion Bengo, mësohet se gjithçka ka marrë shkas për një shuplakë. Sipas burimeve policore, autori i krimit, tashmë i identifikuar dhe i shpallur në kërkim për veprat penale "Vrasje me dashje" ...  
Ne faqet 2-3

## ARSIMI PARAUNIVERSITAR, KATEGORITE QE PERFITOJNE USHQIM FALAS

# VENDIMI I RI I QEVERISE, BURSA PER GJIMNAZISTET

Jetimët, pagesë suplementare për periudhën e pushimeve verore. 2100 bursa për nxënësit e arsimit profesional. Përfitojnë fëmijët me një prind dhe ekselentët



(Në foto) Gjimnazistë (foto Ilustruese)

### STRATEGJIA ELEKTORALE

Sot Asambleja e PS, miratohet kalendari organizativ për zgjedhjet e ardhshme

Në faqen 6

### PD: JE PJESE E AFERES

Veliaj padit Bashën dhe Tabakun: I kanë dhënë vetes leje ndërtimi në bashki

Në faqen 7

### VENDIMI I GJYQIT

Vrau të riun pas sherrit për porosinë e një kënge, 18 vite burg autorit

Në faqen 9

### DIALOG ME SERBINE

Thaçi nuk heq dorë: Pakti me Serbinë, fitojmë njohjen e 5 vende të BE

Në faqen 13

### KRIMI NE SHOQERI



Vrasja në Laprakë, flasin psikologët: Të rinjtë, emancipim i ulët dhe agresivitet

Në faqen 3

Policia u kthen përgjigje organizatorëve: Do procedoheni, nëse do të zhvillohet

## Ndalohet protesta e emigrantëve: Bllokon rrugën

Ballë: Reagimi i diasporës? Po të ftoheshim, do merrnim pjesë edhe ne

Nga VALENTINA MADANI

Policia e Tiranës refuzon kërkesën e emigrantëve për tubim në kryeqytet në ditët e fundit të dhjetorit. Policia e Tiranës nuk i ka dhënë leje protestës së diasporës, e cila nën drejtimin ...  
Në faqen 4



## VRASJA NE TIRANE REAGIMET

### VRASJA E 17-VJEÇARES

Sapo çifti ka hyrë në automjetin tip "Benz E Class" me targa AA266MS dhe ende pa e ndezur atë, janë afruar dy persona të maskuar. Njëri prej tyre, dhe konkretisht 19-vjeçari nga Puka, i cili u identifikua pas ngjarjes, ka qëlluar 5 herë me pistoletë në drejtim të makinës në fjalë. Fillimisht, autori ka qëlluar në pjesën anësore të mjetit dhe pastaj nga pjesa e pasme. Për pasojë, mbeti e vrarë Briselda Gjikota, e cila mori dy plumba në kokë. Ndërsa, drejtuesi i mjetit, Erion Bengo, mbeti i plagosur në qafë dhe në shtatull.



### DENIMI

#### SHANTAZHOI ISH-TË DASHURËN ME VIDEO INTIME, GJYKATA E DËNOI BENGON ME 1.6 VITE BURG

TIRANË - Në atentatin e ndodhur mbrëmjen e së mërkurës në Laprakë mbeti i plagosur me një plumb në shtatull dhe në qafë 23-vjeçari Erion Bengo, person me precedent të mëparshëm penalë. Bengo është arrestuar në vitin 2016 për veprën penale "Shtrengim me anë të kanosjes për dhënie pasurie". I riu u akuzua se në bashkëpunim me 25-vjeçarën me inicialet A.S., ka shantazhuar ish-të dashurën K.L. se, do t'i publikonte një video intime, nëse ajo nuk i jepte 2.000 euro. Pas denoncimit të vajzës, blutë vunë në pranga Erion Bengon për shantazh, ndërsa gjykata e Tiranës e dënoi me 1.6 vite burg.

Rindërtohet dinamika e ngjarjes. Policia, kontroll në banesën e ekzekutorit

# Atentati në Laprakë për një shuplakë, ja si u qëlluan 2 të rinjtë në makinë

*Briselda Gjikota, u vra nga një 19-vjeçar nga Puka.  
Mori hak, 10 ditë më parë u konfliktua me Erion Bengon*

### TIRANË

Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Laprakë, ku mbeti e vrarë 17-vjeçarja Briselda Gjikota dhe u plagos rëndë i dashuri i saj, Erion Bengo, mësohet se gjithçka ka marrë shkas për një shuplakë. Sipas burimeve policore, autori i krimit, tashmë i identifikuar dhe i shpallur në kërkim për veprat penale "Vrasje me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje" është konfliktuar 10 ditë më parë me Bengon, për shkak të viktimës, të cilën e kishte ngacmuar. Në sherr e sipër, 23-vjeçari Erion Bendo e ka gjuajtur atë me shuplakë.

Por shërrit mes të rinjve nuk ka përfunduar me kaq, duke precipituar mbrëmjen e së mërkurës deri në vrasje. Pas atentatit që i mori jetën Briselda Gjikalës me origjinë nga Kurbneshti i Mirditës, blutë janë vënë në ndjekje të vrasësit. Bëhet fjalë për 19-vjeçarin nga Puka, Robert P. Ndërkaq, pas kryerjes së hetimeve nga policia janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen që tronditi banorët e kryeqytetit si dhe është rindërtuar skema e krimit.

### DINAMIKA E NGJARJES

Mbrëmjen e së mërkurës, Erion Bengo në shoqëri të dy vajzave (njëra prej të cilave viktimë) kanë qenë në ambientet e një lokali në bllokun "Gintash" në zonën e Laprakës. Po në të njëjtin lokal kanë qenë edhe dy të



Viktima, Briselda Gjikota


rinj të tjerë, me njërin prej të cilëve 23-vjeçari ishte në konflikt dhe që më pas rezultoi të ishte autori i krimit. Pasi kanë konsumuar kafën (rreth orës 18:17), Bengo është larguar nga lokali i shfaqur nga e dashura e tij, ndërsa dyshohet se çifti i të rinjve është ndjekur pas nga agresori dhe bashkëpunëtori i tij, 17-vjeçarja dhe i dashuri i saj kanë ecur në një rrugicë për në drejtim të makinës që ishte parkuar diku mes pallateve, në një zonë jo shumë të ndriçuar. Sapo çifti ka hyrë në automjetin tip "Benz E Class" me targa AA266MS dhe ende pa e ndezur atë, janë afruar dy persona të maskuar. Njëri prej tyre dhe konkretisht 19-vjeçari nga Puka, i cili u identifikua pas ngjarjes, ka qëlluar 5 herë me pistoletë në drejtim të makinës në

fjalë. Fillimisht, autori ka qëlluar në pjesën anësore të mjetit dhe pastaj nga pjesa e pasme. Për pasojë, mbeti e vrarë Briselda Gjikota, e cila mori dy plumba në kokë. Ndërsa, drejtuesi i mjetit Erion Bengo mbeti i plagosur në qafë dhe në shtatull. Mësohet se i riu ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Burimet e mësipërme pohuan se bashkëpunëtori i 19-vjeçarit nga Puka nuk ka qëlluar me armë, por ka dyshime se e ka ndihmuar atë për t'u larguar. Krismat e armëve kanë alarmuar policinë, e cila ka shkuar shpejt në vendngjarje. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, si dhe pas këqyrjes së pamjeve filmike të siguruar nga kamerat e sigurisë të bizneseve aty afër është bërë i mundur identifikimi i ekzekutorit, i cili është

### KONFLIKTI

Sipas burimeve policore, autori i krimit, tashmë i identifikuar dhe i shpallur në kërkim për veprat penale "Vrasje me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje" është konfliktuar 10 ditë më parë me Bengon për shkak të viktimës, të cilën e kishte ngacmuar. Në sherr e sipër, 23-vjeçari Erion Bengo e ka gjuajtur atë me shuplakë. Por shërrit mes të rinjve nuk ka përfunduar me kaq, duke precipituar mbrëmjen e së mërkurës deri në vrasje. Pas atentatit që i mori jetën Briselda Gjikalës me origjinë nga Kurbneshti i Mirditës, blutë janë vënë në ndjekje të vrasësit.

të shpallur në kërkim. Sipas hetuesve të çështjes, objektiv i atentatit ka qenë 23-vjeçari Erion Bengo. Ky i fundit edhe pse i plagosur ka mundur ta transportojë vetë të dashurën e tij në spital, ku ajo humbi jetën për shkak të plagëve vdekjeprurëse që kishte marrë në kokë. Pa identifikimit të ekzekutorit, uniformat blu kanë ushtruar kontroll në banesën e tij, por ai nuk është gjetur. Të dhënat për 19-vjeçarin u janë shpërndarë të gjitha policive kufitare, pasi dyshohet se ai mund të tentojë të largohet jashtë vendit.



Vendi ku ndodhi ngjarja

### SHKURT

#### Vrasja e gjyqtarës, prokuroria kërkon dënimin me burg përjetë për Fadil Kasemin

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dhënë pretendencën për Fadil Kasemin, i cili vrau ish-bashkëshorten e tij, gjyqtarën Fildes Hafizi. Organi i akuzës kërkoi për burgim të përjetshëm për Kasemin si dhe ta vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë. Gjyqtarja Fildes Hafizi u vra më 31 gusht të vitit 2017 nga ish-bashkëshorti i saj, 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumba pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Ky duket se ishte fundi i një kronike të paralajmëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse kishte marrë një urdhër mbrojtjeje, gjyqtarja merret kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshorti.

#### "Shullazi", gjykata Administrative rrezon Markun për transferimet e prokurorëve

TIRANË - Dy ish-drejtuessit e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Olsian Çela e Besim Hajdarmataj fitojnë betejën me Arta Markun. Gjykata Administrative vendosi të pranohet paditë e dy prokurorëve, të cilët i transferoi kryeprokurorja e përkohshme në rrethe pas një debati që u zhvillua për shortin e dosjes "Shullazi". Gjykata në fjalë ka argumentuar ndër të tjera se urdhrat e Markut për transferimin janë marrë në kundërshtim të plotë me ligjin. Vendimet i hapin rrugë rikthimit të dy prokurorëve te Krimeve të Rënda, kjo edhe për shkak se ka përfunduar edhe afati 3-mujor i transferimit. Megjithatë, që kjo të ndodhë duhet të ketë një vendim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Burimet thanë se KLP pritet të mblidhet të premtën për të diskutuar për rastin e prokurorit Çela, për faktin se ky i fundit e ka vënë në lëvizje përmes një shkresë. E paqartë mbetet fakti nëse vendimet mund të ankohen dhe nëse po, nga cili institucion. Dueshme nga ish-bashkëshorti.



DRAMA

ORIGJINA E FAMILJES

Briselda Gjikota kishte lindur në Kurbnesh të Mirditës, aty ku ka jetuar dhe familja e saj para shpërnguljes në Tiranë. Ajo, vëllai binjak dhe e motra mbetën jetimë para tri vitesh, kur e ëma u nda nga jeta në mënyrë të parakohshme. Të vegjlit morën një goditje të madhe psikologjike e tashmë dy fëmijët po përjetojnë një tjetër humbje, atë të motrës që i rriti.



REAGIMI

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar në lidhje me ngjarjen e rëndë që ndodhi mbremjen e së mërkurës në Laprakë. Me anë të një postimi në "Facebook", Berisha i shpreh ngushëllimet familjes dhe shton se nata e mbremshme në Tiranë ishte një natë e zezë. Më tej ish-kryeministri denon me ashpërsinë më të madhe këtë krim, që e quan të shëmtuar, ndërsa shprehet se sot ka një mungesë totale rendi dhe sigurie.



TRAGJEDIA

TRAUMA NE KLASË

Briselda Gjikota ishte gjimnaziste në shkollën "Aleks Buda", në vitin e dytë, ndërsa lajmi për vdekjen e saj ka traumatizuar shoqet e shokët e klasës. "Është një tragjedi e gjithë jeta e saj, nuk e meritonte këtë fat, sepse ka hequr shumë. Ajo kujdesej gjithmonë për motrën më të vogël dhe të vëllain...", thotë mes lotësh një shoqja e klasës së saj.



Nëna i la jetimë, babai i braktisi, historia e trishtë e 17-vjeçares

# Vëllai i Briseldës: Ishe bota për mua, tani plagë e zemrës


"Më le vetëm disa kujtime që më marrin frymën"

Doriana Bezat

Briselda ishte vetëm një fëmijë, një fëmijë i rritur parakohë, që e gjendur e vetme në Tiranë përpjeqje të kujdesej për vëllain binjak dhe motrën më të vogël. 17-vjeçarja, viktimë e atentatit në Laprakë, pati fat të keq, ashtu si dhe jeta e saj. Në moshën 14-vjeçare nëna e saj ndahet nga jeta duke lënë pas tre fëmijë, ndërsa i ati krijon një jetë të re në Itali. Të gjendur përballë një realiteti të tmerrshëm, 14-vjeçarja atëherë kujdesej si nënë edhe për vëllain e më të voglën e familjes, motrën. Të mërkurën mbrema, vetëm pak ditë para Vitit të Ri, një 19-vjeçar shtiu mbi të dhe të dashurin e saj, vetëm pasi ky i fundit e kishte goditur me shuplakë. Ky mentalitet anormal që për një shpullë vritesh, rëndoi edhe mbi të rinjtë. Briselda Gjikota ndërroi jetë menjëherë pas një plumbi të marrë në kokë, ndërsa u shoqërua në spital nga i dashuri i saj, edhe pse i plagosur rëndë. Briselda Gjikota ishte gjimnaziste në shkollën "Aleks Buda", në vitin e dytë dhe shoqet e shokët e klasës janë tronditur nga ngjarja e rëndë. Ata që e njihnin mirë, njihnin edhe përpjekjet e adoleshentes për t'u kujdesur për më të vegjlit dhe për ta, kjo ngjarje është tragjedi. 17-vjeçarja, viktimë e atentatit në Laprakë kishte rreth një muaj që shoqërohej me 23-vjeçarin Erion Bengo.

**"ISHE BOTA PËR MUA"**

Fjalë zemre kushtuar motrës së tij të ndjerë, e cila humbi jetën dhe tragjikisht pas një atentati me armë në Laprakë. Vëllai i 17-vjeçares Briselda Gjikota për lot me mesazhin e tij, ndërsa i ka kushtuar një dedikim motrës së tij. Teksa ka postuar një



Briselda Gjikota me vëllanë binjak

## Brunilda Laboviti: Emancipimi i ulët po i orienton të rinjtë drejt rivalitetit

Shqipëria po shndërrohet në një arenë ku triumfon nga dita në ditë mentaliteti mesjetar i prapambetur dhe stoik. Një vend ku jeta e njeriut ka fare pak vlerë të sytë e vetë njeriut. Shkalla e ulët e emancipimit dhe bindja se më i fort i fiton, po i orienton të rinjtë që ta këndvështronjë njëri-tjetrin si rival për fronin e të qenit shëmbëlltira të pathyeshmërisë dhe krenarisë. Natyrisht që në një vend ku shpresa po zbehet nga dita në ditë dhe ku marrëdhëniet mes njerëzve më tepër po banalizohen sesa po evokojnë një të ardhme të shndritshme e me shpresë, kjo gjë është e paevitueshme. Një shpeshësi ka qelartë e kriminalitetit, sidomos në moshat e reja nuk gjendet në asnjë vend të Europës dhe kjo ka një



shpjegim të qartë që lidhet pazgjidhshmërisht me frymën e injektuar ndër breza ku çdokujt i mësohet si të mos jetë i nënshtruar, si të shfryjë gjithë emergjinë e akumuluar e si të vetzërthehet nga zinxhirët e një shoqërie që po pëson më shumë regres sesa progres. Askush nuk po njihet pozitën dhe vendin e tij, e më shumë se një problem individual është një problem shoqëror, sepse precedentët e vazhdueshëm të kohëve të

fundit flasin vetë. Fushatat sensibillizuese në Shqipëri nuk mungojnë në aspekte të ndryshme të jetës, por mungon fushata sensibillizuese më e rëndësishme dhe më domethënëse: ajo për vetë JETËN. Nëse nuk mësohet vlera e jetës, nëse nuk mësohet se çdo gjë është e kufizuar dhe të gjithë kemi limite, nëse nuk mësohet se vlera e vetes rritet duke qenë i përlulur e duke punuar për vetë jetën, atëherë vetëm do rrezojmë çdo ditë e më shumë iluzionet që kemi ngritur për një shoqëri të drejtë, me virtytet e me ngrohësit për njëri-tjetrin. S'është asnjëherë vonë për të ndryshuar dhe ndryshimi fillon nga vetë ne, duke e trajtuar veten tonë si një person për të cilin kemi përgjegjësi të plotë që të rrugëtojmë në shoqëri mbarë e mirë.

## Ervisa Lula: Të rinjtë që kryejnë akte të tilla ndihen të përbuzur

Një vajzë 17-vjeçare u vra ditën e djeshme në kryeqytet dhe për fat të keq, ngjarje kaq të rënda po hasin gjithmonë e më shpesh në shoqërinë tonë. Vrasja e Briseldës Gjikolës duhet të shërbejë si një çast reflektimi jo vetëm për të kuptuar pse, por për të reaguar sa më parë. Si psikologe, mendoj se për të analizuar këtë rast duhet të ndalemi tek disa faktorë. Si po i rrisim fëmijët tanë? A është agresiviteti dhe dhuna modeli që po u japim atyre çdo ditë si formën për të fituar mbi tjetrin?! Të rinj dhe adoleshentë, të cilët shëtisin rrugëve të kryeqytetit me armë. Pyetja ime është: "Ku janë prindërit e tyre"? Cilat janë arsyet që e quan autorin t'i merrte jetën



kësaj vajze? Shumica e të rinjve që kryejnë akte të tilla rrefejnë se janë ndier të përbuzur apo kanë qenë të inatosur dhe në psikologji shpjegohet se gjendje të tilla emocionale mund të çojnë në akte të padëshiruara. Frika ime më e madhe është se të tilla modele po i ushqejmë vetë ne. Të rinjtë dhe adoleshentët duhet të kuptojnë se askush nuk është pronë e tyre, dashuria dhe respekti nuk i takon më të fortit, përkundrazi. Prindër, mësues dhe psikologë duhet të jenë bashkë për të vlarë këtë lloj mentaliteti, i cili e sheh vrasjen si alternativë. Tregoni kujdes dhe kontrolloni sjelljen e adoleshentëve, njerëzit me të cilët ata shoqërohen, mësojini ata se jeta vlen më shumë se çdo gjë tjetër, mësojini djemve tuaj se vajzat nuk vriten.

foto në rrjetet sociale, adoleshenti shkruan se Briselda për të ishte bota, ndërsa pas i la vetëm disa kujtime. "Nuk prisja që të kisha një humbje tjetër aq të thellë. Mendoj se do kalonim një jetë plot

gëzime dhe tani m'le vetëm disa kujtime që më marrin frymën dalë ngadalë. Ishe botë më vete për mua dhe do mbetesh plagë në zemër përjetë. U prehash në paqe dashuria ime, motra ime! Të

du pafundësisht. R.I.P", shkruan i vëllai i 17-vjeçares. Krimi i rëndë ku mbeti e vrasë 17-vjeçarja Briselda Gjikota dhe u plagos Erion Bengo ndodhi dje rreth orës 18:17 në Laprakë.

# PROTESTAT AKUZAT

Shkresa e policisë: Nëse protestohet, drejtuesit dhe pjesëmarrësit do të procedohen

## Policia ndal emigrantët: Protesta pengon lëvizjen para Kryeministrit

Organizatori: Protestat e fundvitit, nën një flamur

Valentina Madani

Policia e Tiranës refuzon kërkesën e emigrantëve për tubim në kryeqytet në ditët e fundit të dhjetorit. Policia e Tiranës nuk i ka dhënë leje protestës së diasporës, e cila nën drejtimin e Genc Sejkos, do të mbahet në ditët e fundit të vitit para Kryeministrit. Shumë emigrantë, të cilët vijnë në Shqipëri në këtë fundvit për pushime kishin paralajmëruar protestë para Kryeministrit me 28, 29 dhe 30 dhjetor. Ata kishin ftuar edhe qytetarë të shumtë që t'i bashkohen protestës së tyre para Kryeministrit. Por në shkresën që mban firmën e drejtorit të policisë Tiranë, Kastriot Skënderaj, thuhet se një manifestim i tillë i kërkuar në datat 28, 29 dhe 30 dhjetor në intervale të ndryshme kohore në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" është i pamundur pasi pengon lëvizjen e mjeteve të emergjencës, qarkullimin e mjeteve të transportit publik dhe privat. Po kështu policia paralajmëron se për veprime në kundërshtim me ligjin organizatori dhe pjesëmarrësit në tubim do të mbajnë përgjegjësi administrative dhe penale.

### PROTESTA

Pavarësisht ndalimit të protestës nga Policia e Shtetit, me arsyetimin se pengon lëvizjen e mjeteve të emergjencës, qarkullimin e mjeteve të transportit publik dhe privat, ndërpret veprimtarinë e institucioneve, protesta tre ditore do të zhvillohet në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Vetë organizatori i kësaj proteste ka lajmëruar se pavarësisht refuzimit nga policia, protesta do të zhvillohet në mënyrë paqësore në datat 28, 29 dhe 30 dhjetor. Genc Sejko i njohur si "njeriu i memeve" ishte ideatori i protestës, e cila ka marrë mbështetje të gjerë, kryesisht në rrjetet sociale. "Ne si shqiptarë të diasporës i kemi dhënë qëllim vetes të mbështesim kauzat e drejta të shqiptarëve në Shqipëri, si të studentëve, banorëve të Astirit, minatorëve, invalidëve", informoi Genc Sejko. Emigrantët nga Shtetet e Bashkuara, An-



### SHKRESA

Policia paralajmëron se për veprime në kundërshtim me ligjin organizatori dhe pjesëmarrësit në tubim do të mbajnë përgjegjësi administrative dhe penale. Shumë emigrantë të cilët vijnë në Shqipëri në këtë fundvit për pushime dhe jo vetëm, kishin paralajmëruar protestë para Kryeministrit me 28, 29 dhe 30 dhjetor.

### Ekspozitë me meme dhe pankarta para Kryeministrit

## Ironia e studentëve: Çdo shitje do shkojë për shtëpinë e Ramës në Surrel

Edhe pse studentët e kanë pezulluar përkohësisht protestën, disa prej tyre vazhdojnë të dalin para kryeministrit. Ata zgjedhën dje një formë tjetër proteste për plotësimin e kërkesave të tyre, duke hapur një ekspozitë me memet më pikante të protestës studentore të dhjetorit 2018. Në njëjtën kohë poshtë memeve studentët vendosën dhe emra shtetesh. "Kemi vendosur të bëjmë protestë me art. Sot janë 99 meme. Në pamundësi për të hapur një ekspozitë jashtë vendosëm ta hapim këtu para Kryeministrit. Çdo pankartë është vlerësuar me 20 mijë euro. Çdo para që do të fi-



tohet nga kjo ekspozitë do të shkojë për fondin e shtëpisë së Surrelit, sepse ka akoma për t'u ndërtuar", deklaroi një student. "Janë mesazh për kryeministrin se pas asaj loje që ai bëri dje do vazhdojmë të protestojmë" tha një tjetër student. Vendimet

e qeverisë nuk kanë kënaqur studentët. Ata shprehën se Rama bëri lojë fjalësh. Ata e quajmë VKM e kryeministrit si tallje: "Ishte tallje. Si të thuash hani llokum se bukë nuk ka. Ne i duam të plotësuara kërkesat. Nuk kemi nevojë as për kurse anglishteje falas, por të plotësojë 8 kërkesat sa nuk është vonë". Studentët kishin vendosur dhe tabela me emra shtetesh, për të përfaqësuar të gjithë ata studentë që vijnë studimet jashtë. Ata paralajmëruan vijimin e protestës para kryeministrit deri në plotësimin e kërkesave që kanë paraqitur para ministrit të Arsimit.

gla, Italia, Gjermania e shumë vende të tjera evropiane dhe në kontinente të ndryshme, kishin konfirmuar pjesëmarrjen në protestë. **OPOZITA** Nën kryetari i PD-së Edi Paloka shprehet se Rama urdhëroi ministrin e Brendshëm që në kundërshtim me ligjin të pengojë protestën. "Frikacaku ka urdhëruar ushtar Lleshin, që në

kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën, të pengojë protestën e njoftuar nga emigrantët dhe diaspora për në datën 28 dhjetor. Ky ish-emigrant dhe ish-protestuesi... Po pse ka frikë dhe ju mohojnë të drejtë elementare atyre që praktikisht e mbajnë në këmbë këtë vend financiarisht edhe pas kaq vitesh? Ka frikë, sepse protesta e tyre tregon se shqiptarët brenda apo jashtë vendit, sot janë bashkë, të

gjithë kundër tij. Ka frikë, sepse ata vijnë nga vende që dijnë se c'është liria, nga vende ku për të drejtat luftohet. Ka frikë, sepse ata as nuk i ble e as nuk i kërcënon dot. E meqenëse nuk e merr dot edhe drejtimin e protestës së tyre, siç premtoi për studentët, atëherë ka urdhëruar ndalimin e protestës. Po ka harruar që ata nuk marrin leje tek Rama për të drejtën e tyre..." - shprehet z.Paloka.



Protesta e studentëve

### GENC SEJKO

I njohur si "njeriu i memeve" Genc Sejko ishte ideatori i protestës, e cila ka marrë mbështetje të gjerë, kryesisht në rrjetet sociale. "Ne si shqiptarë të diasporës i kemi dhënë qëllim vetes të mbështesim kauzat e drejta të shqiptarëve në Shqipëri, si të studentëve, banorëve të Astirit, minatorëve, invalidëve", - informon Sejko.

## Nishani: Rama kërcënon studentët se do t'u bëjë vetingun

Ish-presidenti Bujar Nishani iu është bashkuar reagimeve pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama pas Paktit për Universitetin. Përmes një postimi në "Facebook"



Nishani i ka cilësuar mashtrime të gjitha deklaratat e Ramës. Mes të tjerash Nishani shton se Rama nuk i plotëson asnjë prej kërkesave studentëve, madje i kërcënon ata me "vetingun e anglishtes". "Studentët kërkojnë ulje të tarifave në raport me koston e jetesës, ai i kërcënon se do t'u bëjë vetingun për anglishten! Ata kërkojnë plotësimin e kërkesave jetike që të mund të jetojnë dhe studiojnë, ai monologon për propagandë mediale. Asnjë sanksionim real ligjor, asnjë qindarkë e alokuar për ato çka thotë se do ti plotësojë. Vazhdon të gënjëjë. Asnjë fjalë për fazën e dytë të studimeve. Atë të masterit. Ky është modeli i ligjit shqiptar. Të dyja nivelet janë "de facto" të detyrueshme për tregun e punës e për pasojë jetën e studentëve. Jeta e studenteve është futur në kolaps. Jeta e familjeve të tyre është futur në kolaps. Kolapsin nuk e zgjidh vulgariteti digjital i qeverisë. As monologu përpara pasqyrës së dëshimit. Atë mund ta zgjidhin vetëm studentët. Presim studentët...", shprehet z.Nishani.



Policia ndaloi protestën e diasporës, kreu i shtetit: Ejani brenda oborrit të Presidencës

# Paketa për universitetet, Meta: Jo dialog provokues me studentët

"Zgjidhje afatgjatë, bashkëpunim të besueshëm"

Valentina Madani

Presidenti, Ilir Meta, kërkoi dje dialog të sinqertë dhe jo provokues, për zgjidhjen e kërkesave të studentëve. Një ditë pasi qeveria pretendoi se iu dha zgjidhje të 8 kërkesave. Presidenti deklaroi nga Korça se duhet një zgjidhje më afatgjatë për çështjet e arsimit. Sipas tij zgjidhja mund të vijë vetëm përmes dialogut të besueshëm dhe jo atij provokues. Kreu i shtetit u shpreh se mbështet çdo reflektim të sinqertë, ndërsa shtoi se problemi zgjidhet me dialog dhe bashkëpunim konstruktiv. Nga Korça, Presidenti theksoi se për këtë qëllim është harxhuar kohë e vlefshme, ndërsa u shpreh se ai do të mbështesë çdo reflektim të sinqertë e konstruktiv për zgjidhje afatgjatë. "Besoj se është shpërdoruar mjaft kohë e energji tepër e dobishme për të dhënë një zgjidhje të besueshme dhe afatgjatë problemeve të arsimit të lartë dhe studentëve. Unë do të mbështesja çdo reflektim të sinqertë të thelluar të qëndrueshëm në këtë drejtim, që do të thotë se problemi zgjidhet vetëm përmes dialogut të sinqertë dhe bashkëpunimit të besueshëm dhe konstruktiv", - deklaroi kreu i shtetit.



Presidenti Ilir Meta

**PROTESTA**  
"Shqiptarët kanë protestuar edhe në diktaturë, pavarësisht kostove të tmerrshme dhe nuk besoj se një gjë e tillë të ketë ndodhur, por edhe nëse ka ndodhur, janë të ftuar të gjithë emigrantët të protestojnë në oborrin e Presidencës", - deklaroi z. Meta.

**STUDENTËT**

"Unë do të mbështesja çdo reflektim të sinqertë të thelluar të qëndrueshëm në këtë drejtim, që do të thotë se problemi zgjidhet vetëm përmes dialogut të sinqertë, jo provokues, jo ndarës, as intimidues dhe përmes një bashkëpunimi të besueshëm dhe konstruktiv", - tha Meta.

**VASIL: RAMA I ÇMENDUR, MAJKO E HA TURPIN ME BUKË**

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, e konsideroi dje një çmenduri refuzimin nga policia të kërkesës së emigrantëve për protestë para Kryeministrit. Në një dalje për mediat, Vasili tha se frika që ka kapluar kryeministrin nuk kurseu as diasporën dhe kjo është hera e parë që ndodh. Më herët në një postim në "FB", Petrit Vasili, shkruante: "Policia e Ramës dhe e Lleshajt konsumuan turpin më të madh të pluralizmit shqiptar. E neveritshme është se si Pandeli Majko, i pari ministër i Diasporës në histori, rri e vështron këtë turp dhe nuk jep dorëheqjen", - shprehet z. Vasili.

**"Deklaratat e Ramës për studentët, monolog"**

Kryemadhi: Parlamenti drejt shpërbërjes, në 30 qershor dy palë zgjidhje

Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi shpreh bindjen se, 30 qershori nuk do të jetë vetëm data e zgjedhjeve lokale, por edhe atyre parlamentare. "Nga gjithë informacionet që ne kemi e shikojmë që data 30 qershor do jetë ditë zgjedhesh lokale e të përgjithshme", - tha Kryemadhi, e cila u shpreh se parlamenti është shpërbërë. Gjatë takimit me strukturat e LSI-së në Gjirokastrë, Kryemadhi kërkoi nga ata, që të kontaktojnë "gjithë ata socialistët e ndershëm", të zhgënjyer nga "Rilindja". Më herët Kryemadhi, para strukturave në Fier u shpreh se deklaratat e kryeministrit Edi Rama për studentët ishin shfaqje teatrale me monologun e tij. Gjithashtu, ajo ka shtuar se ai nuk plotësoi asnjë prej kërkesave të studentëve. Kryeministri Rama bëri të ditura sot 11 vendimet e qeverisë për studentët, ku miratoi 4 urdhra. "Ajo çka të bën më shumë përshtypje është se sot dëgjonim një konferencë shtypi, një monolog dhe shfaqje teatrale, ku nga njëra anë kishte paralizë faciale, dehe tradhonte fytyra. Ai thoshte se do të përgjysmojmë tarifën e studentëve. Kryeministër mashtroves dhe grabitës. Kërkon që të grabisë inteligjencën e shqiptarëve duke mashturur. Ai duhet të ndryshojë ligjin e arsimit të lartë. Ky kryeministër ose është i paafët mendërisht, por mua s'më duket kështu, pasi ai është i aftë që të grabisë, ose ai mendon se shqiptarët hanë përhersh. Pjesa më e madhe e juaja, kanë fëmijët studentë. I bëj thirrje anëtarëve të LSI që ta fusin kartën në sirtar apo të heqin flamurin e kësaj partie, që t'i bashkohen protestës", - tha Kryemadhi.

**"Kërkesa e diasporës është e ligjshme"**

Protesta e diasporës, Balla: Po të na ftonin, do kishim marrë pjesë edhe ne

Kreu i deputetëve socialistë Taulant Balla reagoi dje për protestën e paralajmëruar nga shqiptarët që jetojnë në diasporë, të cilëve nuk iu dha leja që të protestojnë më datë 28 dhjetor para Kryeministrit. Balla deklaroi për mediat se, nëse do ishin ftuar në këtë protestë, PS do të merrte pjesë. Ai shtoi se Shqipëria i ka një borxh të madh prej 28 vitesh diasporës, pasi kjo e fundit ka kontribuar në ekonomi. "Nëse do ishim ftuar, edhe ne do ishim pjesë e protestës së diasporës. E dimë që Shqipëria i ka një borxh gjithë shqiptarëve që jetojnë në çdo cep të territorit dhe në këto vite janë kontributor i ekono-



misë së vendit. Për PS e drejta e votës të atyre që jetojnë jashtë territorit ka qenë kushti i vetëm që i kemi kërkuar palës tjetër dhe e kemi bërë edhe këtë kur kemi qenë në opozitë, për të përfshirë në kodin e ri zgjedhor votën e shqiptarëve. Edhe në thirrjen e fundit që bëra ne emër të

PS në dy seancat e fundit të Kuvendit, është që të mblidhemi e të votojmë bashkë me opozitës Kodin Zgjedhor që adreson më së miri zgjidhjen. Ndaj në seancë tjetër të mblidhemi dhe të votojmë për këtë reformë. Këta që u merakosën kaq shumë për protestën e diasporës, duhet të bëhen bashkë me ne që të plotësojmë kërkesat e diasporës. Procesi ka qenë i vijueshëm prej kohësh me opozitën", - theksoi z.Balla. Teksa u pyet në lidhje me faktin se pse policia nuk dha leje për protestën, Balla tha se nuk ka nevojë për këtë gjë. Sipas tij kërkesa e diasporës është e ligjshme.

ar të gjithë emigrantët të protestojnë në oborrin e presidencës", deklaroi kreu i shtetit. Deklaratën presidenti e bëri teksa ishte i pran-

ishëm dje në Korçë, në simpoziumin e organizuar nga universiteti "Fan S.Noli" në Korçë dhe Shoqata Maqedone "Sonce", kushtuar ve-

prës dhe krijimtarisë së personalitetit të njohur dhe të veçantë të letrave shqipe, shkrymarrit dhe intelektualit të shquar, Sterjo Spasse.

## ASAMBLEJA VENDIMET

Socialistët ringrenë sërish sistemin e patronazhit të anëtarëve dhe përkrahësve

# Axhenda, zbulohet strategjia e PS-së për zgjedhjet vendore

Miratohet sot kalendar i politiko-organizativ i PS

Socialistët mbledhin sot Asamblesë Kombëtare për të diskutuar mes të tjerave edhe strategjinë elektorale për zgjedhjet e ardhshme vendore që do të mbahen në 30 qershor. Një prej vendimeve më të rëndësishme është edhe miratimi i axhendës politiko-organizative të Partisë Socialiste për periudhën janar-qershor 2019. Në fakt, bëhet fjalë për kalendarin e veprimeve organizative që do të kryejnë socialistët deri në zgjedhjet e ardhshme vendore. Kështu sipas kësaj axhende që do miratohet sot, PS kërkon nga degët që brenda 15 janarit të dorëzojnë regjistrin e anëtarësish së partisë për çdo organizatë, si dhe të strukturave partiake për çdo bashki për vitin 2018. Ndërkohë që deri në fund të muajit janar 2019 do të plotësohet dhe dorëzohet struktura e plotë e rrjetit të koordinatorëve sipas skemës së miratuar në nivel bashkie, njësie administrative dhe sidomos për çdo organizatë socialiste - qendër votimi.

### ORGANIZIMI

Ndërkohë që në periudhën 5 janar - 5 mars 2019 në të gjithë vendin do të kryhet dhe përfundojë procesi për riformatimin e organizatave socialiste në zbatim të vendimit të Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste. Gjithashtu, në funksion të vendimit të Asamblesë Kombëtare për riformatimin e organizatave socialiste brenda datës 15 janar do të zhvillohen mbledhjet e asambleve socialiste të bashkive, ndërsa brenda datës 25 janar do të zhvillohen mbledhjet e kryesive socialiste të njëjësive administrative dhe mbledhjet në organizatave socialiste të bashkive. Po ashtu, në bazë të këtij kalendari veprimesh, socialistët parashikojnë që brenda muajit prill të përfundojë riorganizimi i strukturave vendore rinore. PS e konsideron riorganizimin e FRESH si një domosdoshmëri, pasi siç ka bërë të ditur edhe kryetari i PS-së, Edi Rama, kjo organizatë u tregua inekz-



### KALENDARI I VEPRIMTARIVE KRYESORE ORGANIZATIVE TË PS

- Deri në 15 janar 2019, të përgatitet dhe dorëzohet regjistrin e anëtarësish dhe i strukturave të partisë për çdo bashki dhe strukturë në përbërje të saj për vitin 2018.
  - Deri në fund të muajit janar 2019 të plotësohet dhe dorëzohet struktura e plotë e rrjetit të koordinatorëve sipas skemës së miratuar në nivel bashkie, njësie administrative në përbërje të saj dhe sidomos për çdo OS-QV.
  - Në periudhën 5 janar-5 mars 2019 në të gjithë vendin do të kryhet dhe përfundojë procesi për riformatimin e OS në zbatim të vendimit të AK të Partisë.
  - Në funksion të vendimit të AK për riformatimin e OS brenda datës 15 janar të zhvillohen mbledhjet e AS të bashkive, ndërsa brenda datës 25 janar të zhvillohen mbledhjet e KS të njëjësive administrative dhe mbledhjet në OS të bashkive.
  - Brenda muajit prill 2019 të përfundojë riorganizimi i strukturave vendore rinore.
  - Në muajin mars e në vazhdim veprimtaria e strukturave të partisë do të vihet në shërbim të përmbushjes së detyrave elektorale për kurorëzimin me sukses të zgjedhjeve të reja për pushtetin vendor.
- Kjo veprimtari do të konstatojë:**
- Në njohjen e verifikimit e listave të zgjedhësve për çdo QV.
  - Në organizimin e sistemit të patronazhit të anëtarëve dhe përkrahësve të partisë.
  - Në organizimin e zhvillimit e kontakteve me zgjedhësit, të punës derë në derë, të takimeve me komunitetin në lagje dhe fshatra.
  - Në zhvillimin e një pune intensive sqaruese në vijimësi dhe me intensitet me qytetarët, sidomos me ata të lëkundurit.
  - Në organizimin e takimeve elektorale me kandidatë për kryetarë të bashkive, përfaqësues të PS.
  - Në kontakte në vazhdimësi dhe tërheqje e informacionit të përjavshëm nga strukturat vendore të partisë për ndjekjen e veprimtari se dhe plotësimin e detyrave politike, organizative dhe elektorale nga ana e tyre.

tente gjatë protestës së studentëve.

### ZGJEDHJET

Ndërkohë që nga muaji mars e në vazhdim deri në

30 qershor, veprimtaria e strukturave të partisë do të vihet në shërbim të përmbushjes së detyrave elektorale për kurorëzimin me suk-

### ORGANIZIMI

Nga muaji mars e në vazhdim deri në 30 qershor, veprimtaria e strukturave të partisë do të vihet në shërbim të përmbushjes së detyrave elektorale për kurorëzimin me sukses të zgjedhjeve të reja për pushtetin vendor.

ses të zgjedhjeve të reja për pushtetin vendor. Për këtë qëllim, strukturat e PS-së do të bëjnë njohjen dhe verifikimin e listave të zgjedhësve për çdo qendër votimi, si dhe do të nisë të ringrihet sistemi i patronazhit të anëtarëve dhe përkrahësve. Në këtë mënyrë, PS ka vendosur që edhe kësaj here t'i besojë fortë sistemit të patronazhit, pasi suksesit që ai ka pasur në disa zgjedhje radhazi. Për këtë qëllim do të bëhet organizimi e sistemit të patronazhit të anëtarëve dhe përkrahësve të partisë, i cili nga ana e tij do të nisë organizimin dhe zhvillimin e kontakteve me zgjedhësit, të punës derë në derë, të takimeve me komunitetin në lagje dhe fshatra. Sipas këtij dokumenti përcaktohet se një punë intensive sqaruese në vijimësi dhe me intensitet do të zhvillohet me qytetarët, sidomos me ata të lëkundurit. Gjithashtu, ky kalendar organizimi përcakton edhe punën me organizimin e takimeve elektorale me kandidatë për kryetarë të bashkive, përfaqësues të PS. Në funksion të organizimit zgjedhor parashikohen edhe vendosja e kontakteve dhe tërheqja e informacionit të përjavshëm nga strukturat vendore të partisë për ndjekjen e veprimtarisë dhe plotësimin e detyrave politike, organizative dhe elektorale nga ana e tyre.



## Mblidhet asambleja, Rama pritet të shpallë ndryshimet në qeveri

Pika e parë e rendit të ditës së mbledhjes së sotme të asamblesë është rezervuar fjalës së kryeministrit Edi Rama. Fjalimi i tij pritet me shumë interes, pasi gjatë gjithë këtyre javëve është folur gjatë në lidhje me disa ndryshime që do të bëjë në kabinet. Vetë Rama pas mbledhjes së kryesisë të mbajtur të hënën la të kuptohej se do të kishte të reja rreth kësaj çështje në asamble, ndërsa nuk dihet me saktësi nëse ai do t'i shpallë nesër ndryshimet. Mësohet për një takim që Rama ka pasur me ministrat për të diskutuar rreth së ardhmes së qeverisë, por nuk dihet me saktësi nëse ai i ka komunikuar atyre ndryshimet që do të bëjë. Gjithsesi, ai ndryshimin e qeverisë mund ta ketë të vështirë ta shpallë me emra, për faktin se Kuvendi mblidhet më 21 janar dhe deri atëherë do t'i duhet të qeveriste me ministrat të shkarkuar. Ndaj nuk përjashtohet mundësia që ai të deklarojë nesër nevojën e ndryshimit të qeverisë, ndërsa ndryshimet konkrete t'i bëjë gjatë janarit.



## Largimi i mjekëve, Rama: Kemi listë të gjatë edhe për t'u punësuar

Qeveria prezantoi dje në sheshin "Nënë Tereza" flota e re e autoambulancave të Urgjencës Mjekësore. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe kryeministri Edi Rama, i cili vlerësoi se janë bërë hapa të ndjeshëm për modernizimin e këtij shërbimi. "Sot kemi një urgjencë kombëtare mjekësore të dixhitalizuar që është në gjendje t'i përgjigjet në kohë reale çdo thirrjeje. Nuk ka më histori që bie zilja e telefonit apo telefonit del gjithmonë i zënë se është lënë në atë telin që rrotullohet poshtë, ndërkohë që dezhurni i spitalit gërhet në qejf të vet. Çdo shërbim sot regjistrohet 'online', ndërkohë që koha e ndihmës së parë është shkurtuar në mënyrë të ndjeshme", - tha Rama.



Devijimi i Lanës, PD: Kreu i bashkisë gënjen, plani urbanistik tregon gjurmën ekzakte

# Veliaj padit Bashën dhe Tabakun, PD: I përfshirë në aferën e Unazës

"Ke pjesë në projektin 60 milionë euro"

Valentina Madani

Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj paditi dje në Gjykatën e Tiranës kreun e PD-së Lulzim Bashën dhe deputeten demokrate Jorida Tabaku. Veliaj i ka paditur Bashën dhe Tabakun për shkelje për lejet e ndërtimit kur ushtronin funksionin e kryetarit dhe nënkryetares në Bashkinë e Tiranës. Por krahas kësaj padie, Veliaj e ka paditur Bashën dhe Tabakun edhe për akuzat e bëra ndaj tij për devijimin e rrjedhës së lumit të Lanës dhe projektit të Unazës së Re. Ai kërkon nga Basha dhe Tabaku që të shpërblehet me 100.000 mijë lekë dhe të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe ato avokatore për faktin se, sipas tij, akuzat janë totalisht të pavërteta. Por Partia Demokratike iu përgjigj me një deklaratë padisë së kryetarit të bashkisë së Tiranës Erion Veliaj për kreun e PD Lulzim Basha dhe deputeten Jorida Tabaku: "Roli prej budallai dhe loja me paditë politike me shpresën për të larguar vëmendjen nga skandali, nuk e shpëtojnë Kryetarin e Bashkisë së Tiranës". Sipas PD, Veliaj kapet në flagrancë duke gënjyer për ndryshimin e shtrimit të Lumit të Lanës. "Një vit më parë deklaroi nisjen e punimeve. Pas zbulimit të skandalit tha se projekti nuk është emergjencë për bashkinë. Ndryshe nga sa mashtron Bashkia e Tiranës, harta zyrtare e Planit Urbanistik të Tiranës tregon gjurmën ekzakte sesi është devijuar Lana në favor të projektit 60 milionë euro të trafikantit të drogës", shprehet PD-ja.

**AKUZAT**  
Një ditë pasi Bashkia e Tiranës tha se nuk do të nisë tani projektin për zgjerimin e lumit të Lanës, demokratët e akuzuan kryebashkiakun Veliaj se po mashtron qytetarët. Sipas zëdhënësës së PD-së Ina Zhupa, harta zyrtare e planit Urbanistik të Tiranës tregon gjurmën ekzakte sesi është devijuar Lana në favor të projektit 60 milionë euro të trafikantit të drogës. Ndryshe nga sa mashtron Bashkia e Tiranës, theksoi Zhupa,



Zëdhënësja e PD, Ina Zhupa

## Akuzat e PD, Gjici: Shihemi në gjyq

### Tenderi i universitetit, PD: Rama i dha 1.5 milionë dollarë Gjicit

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se i ka dhënë 1.5 milionë dollarë kompanisë së ish-prefektit socialist të Kukësit Safet Gjici për të kryer punime në Universitetin e Durrësit, ndonëse shpenzimet duhet të mbulohehin nga vetë universiteti. Sipas këshilltarit për çështjet ekonomike, Dorian Teliti kjo nuk është hera e parë që ai favorizohet nga Rama dhe se gjatë gjithë mandatit qeverisës kompania e tij, ka marrë 30 milionë dollarë. "Por klientët, me të cilët Rama mban pushtetin, nuk e ndjejnë krizën, sepse paratë që duhet të shkonin, për shembull për të financuar studimet dhe jetesën e stu-



dentëve në varfëri ekstreme ekonomike, i merr Safet Gjici, kandidati i përhershëm i Edi Ramës për Kukësin. Me aktin e fshehtë normativ, Edi Rama i ka shkurtuar investimet në arsim, por i ka dhënë Safet Gjicit 1.5 milionë dollarë për një punë, për të cilën ai nuk ka lidhur kontratë me qeverinë, por me Universitetin e

Durrësit. Njëpërmjet kompanisë "Kevin Construction", Safet Gjici ka lidhur kontratë prej 5 milionë dollarë me këtë universitet, i cili, sipas dokumenteve të tenderit, duhet të financohej plotësisht nga të ardhurat e vetë Universitetit. Në realitet është ndryshe. "u shpreh Teliti. Por ish-prefekti dhe i deleguari i PS-në Qarkun e Kukësit, Safet Gjici përgënjeshtror akuzat e PD-së se ka përfutur tenderin për universitetin e Durrësit, ndërsa paralajmëron këtë forcë politike për një përballje në gjykatë. Gjici shkruan në 'Facebook' se akuzat e tyre është lehtësisht e verifikueshme, ndërsa e cilëson një gënjeshtëri të radhës.

**SHKURT**

### Unaza e Re, banorët e 'Astirit' në protestë me 6 kërkesa

Banorët e zonës së Astirit protestuan sërisht mbrëmë duke kërkuar dëmshpërblim 100% nga qeveria për banesat që preken nga projekti Unazës së Madhe. Në thirrjet e tyre ata i kanë bërë apel prokurores Arta Marku për të hapur hetimet për Afrim Qëndron dhe Damian Gjikuin. Protestës i janë bashkuar edhe deputetët e opozitës. Banorët shtruan 6 kërkesa: Anulimi i projektit të Unazës së Madhe; Rifillimi i procesit të legalizimit për të gjitha banesat; Rregullimi i kushteve të transportit publik në kryeqytet; Ulja e çmimit të karburantit dhe rritjen e cilësisë së tij; T'u jepen punonjësve të policisë rroga e 13 orët suplementare dhe pagesa e dietave; Plotësimi i kërkesave të studenteve dhe rrëzimi i ligjit të arsimit të lartë. Nga megafoni i protestës u njoftua se ditën e sotme, banorët do t'i bashkohen protestës së diasporës para kryeministrit.

### Tabaku: Korrupsioni gërryen buxhetin, 126 mln USD më pak se parashikimi

Deputetja e PD, Jorida Tabaku shprehet se rritja ekonomike rezultoi përherë më e ulët se sa pritshmëria qeveritare ndërsa mbledhja e të ardhurave është e mangët. Ajo përmend se: "Deri më tani në buxhetin e shtetit rezultojnë 126 mln USD më pak se sa planifikimi fillestar i qeverisë (pra nga parashikimi i kryer në janar 2018)." -shkruan Tabaku, ndërsa thekson se subvencionit i vetëm qeveritar që ka funksionuar në vend është ai i mbështetjes së krimtë të organizuar dhe grupeve kriminale". Sipas Tabakut: "Aktet normative, korrigjimet sporadike të taksave, dhe çdo rregullim tjetër mund të ishin zgjidhje disa vite më parë. E vetmja zgjidhje mbetet rikonceptimi i sistemit fiskal me një taksë të sheshtë, dhënia frymë e biznesit privat, rikonceptimi i modelit ekonomik për të gjetur burime të tjera rritjeje si dhe mbështetja me politika fiskale e atyre që punojnë duke promovuar tregun e lirë dhe jo tregun e komanduar të oligarkëve, siç ka ndodhur në këto vite! Dhurata e qeverisë për shqiptarët në 2018 ka qenë një buxhet me më shumë taksë dhe me më pak mundësi punësimi. Si dhe abuzimi me 957 mln euro me fondet e buxhetit që raporton KLSH në auditimin e fundit për buxhetin e shtetit".

larguar vëmendjen nga skandali, nuk e shpëtojnë Kryetarin e Bashkisë së Tiranës nga pyetja që tani e bëjnë shumë njerëz në Tiranë: Sa është pjesa e Erion Veliaj në projektin rezidencial 60 milionë euro që e detyroi atë të ndryshojë planin urban të Tiranës dhe të zhvendosë Lanën në favor të projektit të trafikantit të drogës Edmond Bego". deklaroi zëdhënësja e PD-së.

Jepen përmes GIZ 10 milionë euro për 100 fshatrat turistike

# Diplomati gjerman: Zgjidhni pronësinë e tokës bujqësore

## Ministri Peleshi: Problemi do zgjidhet në 2019

Të zgjidhet çështja e pronësisë për tokat bujqësore". Kjo është kërkesa që zëvendësambasadori gjerman në Tiranë i bëri ministrit të Bujqësisë, Niko Peleshi. Sipas tij, një sërë investimesh të huaja në bujqësi nuk janë ende në nivelin e premtuar vetëm sepse si kusht duhet që përfutuesit të ketë pronësinë mbi tokën. "Problem është çështja e pronësisë së tokës, çështje me të cilën Shqipëria merret prej shumë vitesh. Ne e konsiderojmë të domosdoshme reformën në këtë fushë dhe zgjidhjen e saj sipas së drejtës europiane. Ky është një kriter kyç për Shqipërinë edhe në rrugën e anëtarësimit të saj në Bashkimin Europian", - tha zëvendësambasadori gjerman, dr. Johannes Dietrich. Ambasada gjermane financoi përmes një marrëveshjeje të firmosur me Ministrinë e Bujqësisë 10 milionë euro përmes një projekti të GIZ, i cili do të ndihmojë në gjenerimin e të ardhurave nga turizmi për 100 fshatrat që ka përzgjedhur qeveria si prioritarë në këtë fushë. Por, një nga problemet kryesore që kanë fondet që japin të huajt në Shqipëri, përfshirë dhe ato IPARD, është pronësia e tokës bujqësore, pasi që të përfutosh nga granti du-



Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi

het që toka të jetë e regjistruar në hipotekë. Nisur nga kjo kërkesë e diplomatit gjerman në takimin me minist-

trin e Bujqësisë, Niko Peleshi, ky i fundit u shpreh se çështja e pronësisë për tokat bujqësore do të zgjid-

### ZV.AMBASADORI GJERMAN

Zëvendësambasadori gjerman, Dr. Johannes Dietrich merret me drejtimin e sektorit ekonomik në ambasadë dhe sigurisht me marrëdhëniet ekonomike mes Shqipërisë dhe Gjermanisë. Detyrë e tij është edhe analizimi i zhvillimit ekonomik në vendin tonë.

het një herë e mirë brenda vitit 2019. "Të gjitha problemet me regjistrimin e tokës bujqësore do të marrin fund me ligjin e ri që parlamenti miratoi në seancën e fundit", tha ministri.

### Ekonomia botërore do ngadalësohet në vitin 2019

"Ekonomia botërore do të ngadalësohet në 2019-ën dhe më pas do të stabilizohet", - deklaroi Banka Qendrore Europiane, duke pritur ndërkohë që çmimet të rriten. Investitorët janë duke u përgatitur për një ngadalësim në mbarë botën në rritjen ekonomike, kryesisht të nxitur nga kostot më të larta huamarrëse për debitorët e dollarit dhe tensionet tregtare midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Aktiviteti ekonomik global pritet të ngadalësohet në 2019 dhe të mbetet i qëndrueshëm më pas", tha BQE. "Presionet globale inflacioniste pritet të rriten ngadalë, ndërsa kapaciteti rezervë zvogëlohet". Buletini ilustroi vendimin e BQE në mbledhjen e tij të dhjetorit për t'i dhënë fund programit të blerjes së obligacioneve prej 2.6 trilionë dollarësh (\$ 2.96 trilionë), por vazhdon të rinvestojë paratë që merr nga letra e maturimit në një kohë të gjatë pas rritjes së normës së parë. Vendimi u kritikua nga disa si i parakohshëm duke pasur parasysh ekonominë e dobët. Por BQE, objektivi i vetëm i të cilit po godet objektivin e saj të inflacionit, riafirmoi besimin se çmimet bazë do të vazhdojnë të rriten në eurozonë.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

### SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall:

- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit.

#### KËRKESA TË POSAÇME:

- Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

#### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



Prokuroria kërkoi dënimin me 20 vite heqje lirie të Maringlen Përgjinit

SHKODËR

# Vrau të riun pas sherrit për porosinë e një kënge, dënohet 18 vjet burg autori

Afro 6 vite pas vrasjes së të riut Maldin Shtjefni, ka përfunduar gjykimi për autorin e krim-it. Bëhet fjalë për Maringlen Përgjinit, i cili është shpallur fajtor për ngjarjen e ndodhur në fillim të vitit 2013 në Lezhë. Gjykata e Apelit në Shkodër dha vendimin e formës së prerë duke dënuar në total me 18 vite burg Përgjinitin, ndërsa Anton Toli u dënua me 2 vite dhe Sergjo Prenga me 9 muaj. Këta dy të fundit për veprën penale "Moskallëzim krimi". Apeli në Shkodër la të lirë Ergys Nikën, i dyshuar edhe ai për "Moskallëzim krimi". Dy javë më parë, prokurori i Apelit Shkodër, Elvin Bogaj lexoi konkluzionet përfundimtare ndaj të pandehurit Përgjinit, duke kërkuar dënimin e tij me 20 vite burgim për akuzat "Vrasje me dashje" dhe "Prodhim dhe mbajtjes pa lejë të armëve luftarakë". Ngjarja për të cilën u dënua me 18 vite heqje lirie Maringlen Përgjinit ndodhi në janarin e vitit 2013 në një lokal me muzikë, në Lezhë. Viktima Maldin Shtjefni ishte në lokal bashkë me shokun e tij, Sergjo Prenga, ndërsa në një tavolinë tjetër ndodhej Ergys



Viktima Maldin Shtjefni



Autori Maringlen Përgjini

Nika, Anton Toli dhe disa persona të tjerë. Ergysi dhe Maldini kanë bërë sherr për porosinë e një kënge, se cila duhej të këndohej më parë nga grupi muzikor. Pasi debati mes tyre është mbyllur në lokal, ka mbërritur edhe Maringlen Përgjini. Viktima Maldin Shtjefni dhe shoku i tij Sergjo janë thirrur në tavolinën ku ndodhej

Përgjini dhe Ergysi bashkë me disa të tjerë. Pasi janë bashkuar, papritur Maldin Shtjefni është qëlluar me një plumb në ballë, duke mbetur i vdekur në vend. Fillimisht dëshmitë e dëshmitarëve kanë rënduar mbi Maringlen Përgjinitin, i cili qëndroi 16 ditë në kërkim policor. Më pas ngjarja është tentuar të ndryshohet. Maringlen

Përgjini akuzon Ergys Nikën si autor të vrasjes, ndërsa Ergysi akuzon pikërisht Maringlenin.

## VENDIMET E GJYKATAVE

Herën e parë Gjykata e Shkallës së Parë në Lezhë e dënoi me 5 vite Maringlen Përgjinitin për armëmbajtje dhe vrasje nga pakujdesia. Me kërkesë të prokurorisë,

çështja u ridërgua për gjykim nga Gjykata e Apelit në Shkodër në gjykatën e Lezhës, por herën e dytë në 2016-ën Maringlen Përgjini u shpall i pafajshëm. Pasi çështja erdhi për herë të dytë në Gjykatën e Apelit në Shkodër, prokurori i Apelit, Elvin Bogaj rindërtoi thujtë këto ngjarje duke arritur në konkluzionet përfundimtare dhe duke kërkuar 20 vite burg për Maringlen Përgjinitin si autor i dyshuar i vrasjes. Avokati mbrojtës i Përgjinit, Ferit Muça akuzoi prokurorin e Apelit se ka shtrembëruar dosjen, ndërsa deklaroi se në bazë të përgjimeve në bisedat e dëshmitarëve dhe të afërmeve të të pandehurve rezultuan se autor i vrasjes është shtetasi Ergys Nika. Petrit Mhillaj, avokati që mbrojtë Ergys Nikën tha se klienti i tij nuk është autor i vrasjes, sepse siç thonë dëshmitarët, nuk ka pasur

fare armë dhe se arma ka qenë e Maringlenit. Nga ana tjetër, avokati i viktimës Idajet Beqiri tha se është dakord me prokurorin e Apelit dhe se Maringlen Përgjini në bazë të të gjitha dëshmitarëve pas vrasjes është autori që kreu krimin duke qëlluar me plumb në ballë Maldin Shtjefnin. Prokurori i Apelit në Shkodër, Elvin Bogaj nuk u shpreh, ndërsa u mjaftua me dosjen e paraqitur dhe arsyetimet përkatëse duke kërkuar 20 vite burg për Maringlen Përgjinitin. Në fund, trupi gjykuar me kryesues Vojsava Osmanajn dhe anëtarë Astrit Kalaja dhe Marina Raboshita vendosi dënimin në total me 18 vite burg për Maringlen Përgjinitin. Ky i fundit më përpara ka goditur në Lezhë prokurorin Ervin Beqiri, ndërsa ndodhej në burg, ndërsa është kapur edhe me një sasi droge në burgun e Burrelit.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

### RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

### "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

#### KËRKESA TË POSAÇME:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

#### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët

e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njëjtuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

# ARSIMI PARAUNIVERSITAR BURSAT DHE KONVIKTET

"Si do të jepen pagesat bazuar në kushtin ekonomik, rezultatet dhe statusin"

## Vendimi i qeverisë: Bursa për nxënësit e parauniversitarit


"Kriteret për të përfitur për secilën kategori"

Voltiza Duro

Nxënësit e arsimit parauniversitar që plotësojnë kriteret e përcaktuara mund të marrin bursë e përfitime të tjera bazuar në vendimin më të fundit të Këshillit të Ministrave. "Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore, publike, të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë", theksohet në vendim.

### KRITERET

Për të përfitur bursën, studentët e parauniversitarit duhet të plotësojnë kriteret që janë: kriteret ekonomike (bazuar në largësinë e shkollës nga banesa e nxënësit dhe gjendjen ekonomike); kriteret sipas rezultateve të arritura; kriteret jashtë kriterit ekonomik; si dhe sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional.



### BURSA

Për të përfitur bursën, studentët e parauniversitarit duhet të plotësojnë kriteret që janë: kriteret ekonomike (bazuar në largësinë e shkollës nga banesa e nxënësit dhe gjendjen ekonomike); kriteret sipas rezultateve të arritura; kriteret jashtë kriterit ekonomik; si dhe sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional.

kanë humbur kujdesin prindëror. Gjithashtu, bursën e arsimit parauniversitar mund ta marrin edhe nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mesimore mekanike, elektroteknike, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulike; nxënësit/fëmijët me një prind. "Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2018, për këto kategori nxënësish, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkudjesjes sociale rezidenciale publike duhet të dërgojnë në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore

përkatese, ku ata ndjekin studimet, listën e nxënësve përfutues, sipas pikës 2.3, të këtij vendimi", -thuhet në vendimin e publikuar në Fletoren Zyrtare. Bursa do të marrin edhe nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mesimore: bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkimi, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit; si dhe me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë. "Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfutimit të saj, kur: janë ndarë nga trangu familjar; familjet e tyre ushtriojnë veprimtari private; shpallen ngelës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese", -theksohet në vendim.

### KRITERET PËR TË MARRË BURSË:

**Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:**

- 2.1. Sipas kriterit ekonomik:**
  - a) Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre dhe që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - b) Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët akomodohen në konvikte publike dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1.
- 2.2. Sipas rezultateve të arritura:**
  - Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjetë).
- 2.3. Jashtë kriterit ekonomik:**
  - a) Nxënësit, të cilët kanë përfutur statusin e jetimit;
  - b) Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;
  - c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;
  - d) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
  - e) Nxënësit, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invaliditetit dhe nuk kanë të ardhura të tjera;
  - f) Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
  - g) Nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
  - h) Nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes

nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

- f) Nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mesimore mekanike, elektroteknike, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulike;
- g) Nxënësit/fëmijët me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2018, për këto kategori nxënësish, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkudjesjes sociale rezidenciale publike duhet të dërgojnë në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore përkatese, ku ata ndjekin studimet, listën e nxënësve përfutues, sipas pikës 2.3, të këtij vendimi.

- 2.4. Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:**
  - a) në drejtimet mesimore: bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkimi, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit;
  - b) me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.
- Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfutimit të saj, kur:**
  - a) janë ndarë nga trangu familjar;
  - b) familjet e tyre ushtriojnë veprimtari private;
  - c) shpallen ngelës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.



Vendimi: Jetimët, pagesë suplementare për periudhën e pushimeve verore

# Arsimi parauniversitar, kush përfiton ushqim e akomodim falas

"2100 bursa për nxënësit e shkollave profesionale"

Voltiza Duro

**D**isa kategori të tjera nxënësish të arsimi parauniversitar do t'u sigurohet falas edhe fjetja, shërbimi shëndetësor e dentar si dhe medikamentet. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e plotë të qeverisë mbi nxënësit që do të kenë të drejtë të përfitojnë falas shërbimet e sipërpërmendura. "Nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë, përfitojnë çdo vit, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë, përfitojnë çdo vit, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë institucionet shtetërore. Nxënësve, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, invalidit paraplegjik, tetraplegjik, statusin ligjor të personave që nuk shikojnë, të personave që nuk dëgjojnë, u sigurohen falas akomodimi/fjetja, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet pas paraqitjes së librezës, kartës shëndetësore dhe epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit. Nxënësit jetimë, të cilët ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit parauniversitar, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale. Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët vazhdojnë studimet në shkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psikosociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit, me një kuotë ushqimore (drekë) me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr.4. Nxënësve të arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km dhe që akomodohen në konvikte publike, bursa u jepet në formën e kuotës ushqimore. Në asnjë rast bursa nuk jepet në formën e kuotës financiare. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë sipas rezultateve të arritura, jashtë kriterit ekonomik, që janë akomoduar në konvikte ose jo, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të nxënësve/prindërve. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, për vitin e ri shkollor 2018-2019 të japë 800 (tetëqind) bursa.



31

**JANAR 2019**

Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave është data 31 janar 2019. Vendimet e këshillave të njësitë të vetëqeverisjes vendore, të miratuara jashtë këtij afati, janë të pavlefshme.

2100

**BURSA, ARSIMI PROFESIONAL**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, që ndjekin shkollat profesionale, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, për vitin e ri shkollor 2018-2019, të japë 2 100 (dy mijë e njëqind) bursa.

institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psikosociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit, me një kuotë ushqimore (drekë) me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr.4. Nxënësve të arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km dhe që akomodohen në konvikte publike, bursa u jepet në formën e kuotës ushqimore. Në asnjë rast bursa nuk jepet në formën e kuotës financiare".-nënvizon Këshilli i Ministrave.

**FORMAT E BURSËS**

"Nxënësit, të cilët gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore kanë përfituar bursë nga njësia bazë e vetëqeverisjes vendore, e përfitojnë atë dhe

gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore ose të kuotës financiare, drejtpërdrejt në llogarinë bankare të nxënësit/prindërit, të çelur pranë bankave të nivelit të dytë. Për nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë për vitin shkollor 2018-2019, drejtoritë e shkollave profesionale si dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar dërgojnë zyrtarisht, në datën 5, të çdo muaji, pranë njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, informacion të detajuar për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë".-thuhet në vendim. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë sipas rezultat-

eve të arritura, jashtë kriterit ekonomik, që janë akomoduar në konvikte ose jo, masa e miratuar e bursës mujore do tu paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të nxënësve/prindërve. Ndërkohë, nxënësve, të cilët nuk ndjekin mësimin/shkollën apo praktikën profesionale pa arsyë ligjore apo shëndetësore, u ndërpriten bursa menjëherë. Masa e bursës dhe kuota financiare ushqimore ditore për nxënësit jepet, respektivisht, sipas pasqyrave nr.2 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, që ndjekin shkollat profesionale, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, për vitin e ri shkollor 2018-2019, të japë 2 100 bursa.

Fluksi i emigrantëve në pikat kufitare/ Policia zbardh masat për mbarëvajtje

# Ndryshimet në kufirin Shqipëri-Kosovë, Lleshaj: Do të hiqen kontrollet e dyfishta

## Ministri i Brendshëm: Hapat e tjera që do të ndërmerrem

Së shpejti do të ketë ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kufirit me Kosovën. Lajmi është bërë i ditur ditën e djeshme nga ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, i cili ka theksuar se do të hiqen kontrollet e dyfishta por do të merren edhe masa të tjera për të patur kështu standarde europiane në kufirin Shqipëri-Kosovë. "Ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kufirit me Kosovën. Kontrollet e dyfishta hiqen. Policinë e të dy vendeve do të kryejnë së bashku kontrollet sipas parimit një ndalesë një kontroll. Qeveria miratoi dje vendimin për këtë ndryshim të rëndësishëm, - thotë Lleshaj.



Në kuadër të festave të fundvitit, Policia Kufitare është angazhuar maksimalisht për të përballuar fluksin e hyrje-daljeve në të gjitha pikat e kalimit të kontrollit kufitar tokësor, porte dhe aeroportin "Nënë Tereza". Në të gjitha pikat janë shtuar sportelet në hyrje e dalje, me qëllim krijimin e lehtësive ligjore duke eliminuar radhët e gjata, si dhe për t'u ofruar një shërbim cilësor e në kohë, të gjithë shtetasve shqiptarë e të huaj. Prej datës 20 deri 27 dhjetor 2018

nga të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar ka patur fluks në hyrje dhe lëvizje normale në dalje, konkretisht: kanë hyrë 266.219 shtetas, nga këta 178.120 shtetas shqiptarë, 88.099 shtetas të huaj, si dhe 81.605 mjete. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, rezultojnë rreth 13 % shtetas shumë; kanë dalë nëpërmjet pikave të kalimit 170.879 shtetas dhe 52.270 mjete. Rezultoni se gjatë periudhës 20-27 dhjetor 2018 kanë dalë rreth 19 % më pak se për të njëjtën periudhë të vitit 2017. "Në

kuadër të masave, Policia Kufitare po bashkëpunon ngushtë me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, si dhe me policinë homologe. Është rritur prezenca policore në patrullim në kufirin jeshil e atë blu, me qëllim

### NDRYSHIMET

"Ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kufirit me Kosovën. Kontrollet e dyfishta hiqen. Policinë e të dyja vendeve do të kryejnë së bashku kontrollet sipas parimit një ndalesë një kontroll. Qeveria miratoi dje vendimin për këtë ndryshim të rëndësishëm", - thotë Lleshaj.

### PARANDALIMI

Është rritur prezenca policore në patrullim në kufirin jeshil e atë blu, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale që mund të tentohet të kryhet nëpërmjet kufirit jeshil apo atij blu", - thuhet në njoftim.

parandalimin, evidentimin dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale që mund të tentohet të kryhet nëpërmjet kufirit jeshil apo atij blu. Departamenti i Policisë Kufitare fton qytetarët që të denoncojnë çdo rast të abu-

zimit me detyrën nga punonjësit e policisë në numrin 112, aplikacionin Komisarati Dixhital, në numrin jeshil 0800 90 90 duke ju garantuar reagim të shpejtë, profesional e të paanshëm", - thuhet në njoftim.

**MASAT, POLICIA KUFITARE**

## "Vizitoni faqen travel.state.gov"

### Vendimi i Trump, ambasada: Pasaportat dhe shërbimet e vizave vazhdojnë

Në një kohë që Presidenti Donald Trump ka vendosur mbylljen e pjeshme të qeverisë, ambasada amerikane në Tiranë ka një njoftim të rëndësishëm. Ambasada përmes një postimi në 'Facebook' shkruan se pasaportat dhe shërbimet e vizave në SHBA, në ambasadat amerikane dhe konsullatat jashtë vendit do të vazhdojnë edhe gjatë vonësës së buxhetit. Më tej ambasada sugjeron për të gjithë të interesuarit që të vizitohen faqen travel.state.gov për çdo informacion apo shërbim që iu nevojitet, në një kohë që faqja zyrtare e ambasadës amerikane nuk do të përditësohet



deri në funksionimin e plotë. **NJOFTIMI** "Në këtë kohë, pasaportat e planifikuara dhe shërbimet e vizave në Shtetet e Bashkuara, në Ambasadat Amerikane dhe Konsullatat jashtë vendit do të vazhdojnë gjatë vonësës së buxhetit siç lejon situata.

Ne nuk do ta përditësojmë këtë faqe deri në funksionimin e plotë, me përjashtim të informacioneve urgjente që lidhen me sigurinë. Për informacione mbi shërbimet tona dhe statusin operativ, vizitoni: travel.state.gov", shkruan në postim ambasada.

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

**CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT  
"AIRFIELD 2020" PROJECT  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Presidenti kosovar: Ekipi ynë më 8 janar do të jetë në Bruksel

# Thaçi: Me marrëveshjen, Kosova fiton njohjen nga Serbia dhe 5 vendet e BE-së

## Thaçi heq dorë nga grupi negociator

Ditën e djeshme presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi deklaroi se më 8 janar ekipi negociator do të jetë i pranishëm në Bruksel për të vijuar negociatat me Serbinë. Në takim të fundit për këtë vit me gazetarë, Thaçi përsëriti se do t'i mbështesë të drejtat e shqiptarëve në Luginë, e shtoi se ekipi negociator është pajtuar që më 8 janar të jenë në Bruksel, ndërsa, ai do të jetë për skijim në Brezovicë. "Ne do të punojmë shumë seriozisht duke iu përgjigjur nevojave të vendit, qytetarëve, shtetit për fqinjësi të mirë, që në muajt në vijim të arrihet marrëveshje gjithëpërfshirëse, që Kosova të fitojë njohjen nga Serbia me një marrëveshje e balancuar. Ekipi negociator do ta ketë përkrahjen time të plotë dhe se Kosova është gati për dialog", tha ai. "Ekipi negociator është pajtuar me propozimin tim që më 8 janar ata të jenë në Bruksel dhe unë në Brezovicë për ski". Një ekip që i tregon Beogradit dhe ndërmjetësuesve ndërkombëtarë se Kosova është unike në qëndrimet e saj në dialog. Hashim Thaçi, president i Kosovës: Tani është ekipi negociator i votuar nga Parlamenti i Kosovës që ka fituar një legjitimitet të fuqishëm. Ky ekip negociator e ka pasur, e ka dhe do ta ketë mbështetjen time të plotë. Thaçi ishte i pranishëm gjatë mbledhjes me ambasadorët e vendeve të QUINT-it, të cilëve ekipi i ri u prezantoi platformën e re të dialogut, me pikat kryesore njohjen e Kosovës nga Serbia dhe anëtarësimin e vendit në OKB. Fatmir Limaj, kryenegociator për Kosovën: Ambasadorët shprehën mbështetjen e plotë. Të gjithë shprehën gatishmërinë e tyre për të ndihmuar Kosovën në këtë hap të rëndësishëm final që do të sillte një marrëveshje të rëndësishme detryeuese për dy vendet. Teksa Shtetet e Bashkuara kanë marrë një rol më aktiv në nx-



itjen e arrijtes së një marrëveshjeje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, siç tregoi edhe letra që shefi i Shtëpisë së Bardhë u dërgoi presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, e përditshmja serbe Danas shkruan se zv/ndihmës sekretari i shtetit Palmer do të ketë rol kryesor në vazhdim të dialogut mes dy vendeve. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi thotë se Kosova është e gatshme për dialog me Serbinë dhe për arrijtes e një marrëveshjeje, gjithëpërfshirëse dhe balancuese. Sipas presidentit Thaçi, marrëveshja eventuale me Serbinë, do të jetë në interes të paqes. Ai shprehu besimin e tij se një marrëveshje me Serbinë është

të mundshme. Sipas Thaçit, me arrijtes e marrëveshjes, Kosova do të fitojë njohjen nga Serbia si dhe nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, që deri më tani nuk e kanë njohur Kosovën. Por, Thaçi përmendi edhe pasojat me të cilat do të përballë Kosova, nëse marrëveshja nuk arrihet. "Kosova e fiton njohjen nga Serbia, e fiton njohjen nga pesë vendet e Bashkimit Evropian - nëse arrihet marrëveshja dhe unë shpresoj që do të arrihet dhe besoj në këtë drejtim. E fiton njohjen globale, sepse do të jetë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, do të bëhet pjesë e të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe e fiton vendin e sigurt për

NATO dhe BE". Presidenti Thaçi sërish përsëriti qëndrimin e tij se ai dëshiron që Luginë e Preshevs, Medvegjes dhe Bujanocit t'i bashkohen territorit të Kosovës. "Unë mbështes në plotni të drejtat kombëtare të Luginës së Preshevs, Medvegjes dhe Bujanocit. Në muajt në vijim shpresoj në zyrtarizimin e të drejtës së tyre për bashkëngjitime me Kosovën", u shpreh Thaçi. Thaçi ftoi të gjithë t'i bashkohen procesit të dialogut me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe në fund të arrihet marrëveshja, e cila, sipas presidentit, ka mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

**Shpërthim jashtë kishës në Greqi, plagoset rëndë polici**  
Ditën e djeshme ka ndodhur një shpërthim në Skoufa Street, jashtë një kishë në Kolonaki, duke lënë të shpërfytyruar një polic grek. Raportohet se shpërthimi ka ndodhur afër një mekanizmi, i cili ishte vendosur jashtë kishës së Agios Dionisios, në hyrjen anësore dhe brenda një objekti metalik. Pas thirrjes, një oficer patrullimi ka shkruar në pikën dhe iu afrua objektit me neokoronacionin e shenjtërores. Atëherë mekanizmi shpërtheu, duke shkaktuar plagosjen e policit në duar e fytyrë. Efekti u transferua në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak, ndërkohë pati edhe një kishtar të kësaj kishë, i cili u plagos dhe u transportua në spitalin Evangelismos për dhënim e ndihmës së parë. Dëshmitarët në vend thanë se u dëgjua një shpërthim i fuqishëm i shoqëruar me dritë. Rrugët rreth kishës së Agios Dionisios janë të mbyllura. Hetimi paraqark i kryer nga policia, dyshohet për akt terrorist. Informacioni i deritanishëm tregon se nuk kishte thirrje paralajmëruese për policinë apo për mediat.

**HASHIM THAÇI**  
"Kosova e fiton njohjen nga Serbia, e fiton njohjen nga pesë vendet e Bashkimit Evropian - nëse arrihet marrëveshja dhe unë shpresoj që do të arrihet dhe besoj në këtë drejtim. E fiton njohjen globale, sepse do të jetë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, do të bëhet pjesë e të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe e fiton vendin e sigurt për NATO dhe BE", - ka thënë Thaçi.

### Haradinaj: Vendi ynë ka nevojë për unifikim të qëndrimeve

Ramush Haradinaj, kryeministri i Republikës së Kosovës, ka marrë ditën e djeshme pjesë në takimin e delegacionit shtetëror për dialogun Kosovë-Serbi, pjesë e së cilës ishin edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, zëvendës kryeministria, si dhe ambasadorët e shteteve të Quintit. Në takimin e dytë me radhë, për çështjen e dialogut me Serbinë, qëllimi ishte që të tregohet përkushtimi i institucioneve të vendit për fazën finale të bisedimeve dhe njoftimi i ambasadorëve të Quintit për ecurinë deri tek krijimi i këtij delegacioni. Kryeministri Haradinaj tha se është angazhuar që nga fillimi që të ketë dialog përmbytësor, transparent dhe në interes të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke angazhuar ekipin më të mirë dhe ekspertët të jashtëm që Kosovës t'i prezantojnë ekipin negociator dhe dokumentin bazë, librin me shumë kapituj për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme mes Kosovës dhe Serbisë. "Kosova ka nevojë për unitet dhe unifikim të qëndrimeve të krejt spektrit politik në vend, me qëllim të arrijtes së një marrëveshjeje që është në përputhje të plotë me vullnetin politik të popullit të Kosovës, të shprehur me 17 shkurt 2008 nga Parlamenti i Republikës së Kosovës", - ka thënë kryeministri Haradinaj. Ambasadorët e Quintit i kanë dhënë mbështetje këtij delegacioni dhe po ashtu kanë kërkuar unitet dhe përfshirje të gjithë spektrit politik në fazën finale të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.



### Gruevski në azil, gjykata maqedonase pranor masën e paraburgimit

Rasti "Trajektorja", avokati mbrojtës i ish-kryeministrit heq dorë, gjykimi shtyhet për 30 janar



Goran Boshevski fillimisht konstatoi se avokatët e Nikolla Gruevskit kanë hequr dorë nga përfaqësimi i tij

dhe i caktoi Gruevskit një avokat sipas detyrës zyrtare. Avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare për Nikolla

Gruevski kërkoi që seanca e djeshme të shtyhet në mënyrë që të përgatiten për seancën për shkak të vëllimit të rastit. Në "Trajektorja" akuzohen ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-zëvendës kryeministri Vlladimir Peshevski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve Mile Janakievski dhe ish-drejtori për Rrugë Shtetërore, Lupço Georgievski, se në vitin 2012/2013 i kanë tejkaluar autorizimet e tyre në procedurën për përzgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e pjesëve të autostradës deri në Shkup dhe Ohër.

Gjykimi për rastin "Trajektorja" të Prokurorisë Speciale Publike do të vazhdojë më 30 janar në mënyrë që avokati i caktuar nga gjykata për mbrojtjen e Gruevskit të ketë kohë të përgatitet për rastin. Gjykata ka pranuar edhe kërkesën e Prokurorisë Speciale Publike që të akuzuarit në arrati Nikolla Gruevski t'i vendoset masa e paraburgimit. Në fillim të seancës Lile Stefanovska nga PSP-ja ka kërkuar paraburgimin për të akuzuarin Nikolla Gruevski, i cili është në arrati dhe nuk është në dispozicion për autoritetet, ndërsa avokati i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare ka reaguar ndaj këtij propozimi dhe kërkoi që vendimi të hidhet poshtë si i pabazë. Gjykatësi

Tayna performancë 'live' në Tiranë, zbuloni surprizën

# Ja ku do e kalojnë natën e ndërrimit të viteve artistët shqiptarë

*Ledri Vula mban titullin "kampion" për hitet*

Egla Xhemali

Atmosfera e festave ndihet kudo. Janë ditët e fundit të një viti, që mund të themi se ka qenë një bum sukseesi për shumë artistë shqiptarë. Nuk kanë qenë të pakta bashkëpunimet që kanë bërë këngëtarët më në zë të tregut muzikor e që fansat vazhdojnë t'i dëgjojnë edhe sot. Natyrshëm lind pyetja: Ku do jenë artistët më të dashur shqiptarë gjatë festave të fundvitit? Më poshtë do të zbuloni ku do të performojnë ata në ditët e festive.

## LEDRI VULA

Ledri Vula është një nga reperat më të kërkuar të momentit. Ky vit për të ka qenë mjaft i suksesshëm falë bashkëpunimeve të shumta, që i siguruan për muaj me radhë titullin e "kampionit" në 'playlista' muzikore. Koncerte pafund në Kosovë, Shqipëri e diasporë. Reperi nëpërmjet videove të postuara në rrjetet sociale ka falënderuar fansat e tij që i kanë dhuruar momente plot emocione. Ashtu sikurse edhe këtë vit, Ledri nuk do largohet nga Kosova natën e ndërrimit të viteve. Ai do performojë 'live' në klube në qytete të ndryshme në Kosovë përgjatë këtyre ditëve për të kulmuar më datë 31 në Prishtinë.

## TAYNA

Ajo ka qenë surprizë për të gjithë artistët. Me një stil unik dhe me energji të jashtëzakonshme për një kohë tejet të shkurtër Tayna arriti të bëhet "mbretëresha" e repit. Ajo ka pohuar në intervista televizive se gjithçka i erdhi e papritur e se kurrë nuk do mendonte se do i ngjiste hapat kaq shpejt. Edhe reperja e ka axhendën mjaft të ngarkuar ditët e festave. Klubet janë vendet që mund ta gjeni mjaft lehtë bukuroshen, e sa për vendndodhjen, ajo më së shumti do jetë në qytetet e Kosovës. Më datë 31 reperja do performojë në Tiranë. Të gjithë fansat e reperes duhet të gëndrojnë gati.

## DHURATA DORA

Ajo njihet për këngët ritmike që shumë shpejt shndërrohen në hite dhe për frymën krejt ndryshe që do t'i sjellë tregut shqiptar. Një jetë mes Gjermanisë dhe Kosovës, qindra klikime në "Youtube", stil i veçantë dhe



koncerte kudo në botë. Është fjala për Dhurata Dorën. Bukuroshja që po shijon suksesin e hitit më të fundit "Qikat e mia" ka pasur një vit me shumë punë, por që ka rezultuar i suksesshëm. Edhe këto

ditët e fundit të vitit ajo do jetë duke performuar në Kosovë e më vonë përtej kufijve. Fansat e saj do këndojnë së bashku me të duke filluar që nga data 28, për të vazhduar edhe ditët e para të janarit.



## GETOAR SELIMI

Pas krizave brenda grupit "Babastars", ai nuk ka në plan ta ulë kokën. Getoar Selimi që ka dalë paksa jashtë vëmendjes së publikut për shkak të rivalitetit të fuqishëm që ka me reperin

Noizy, ka arritur në përfundimin se ky vit ka qenë i mbarë për të. Reperi që së fundmi ka publikuar një bashkëpunim me Flori Mumajesin dhe Brunon, do e nisë vitin e ri duke performuar. Bëhet e ditur

se të gjitha këto ditë ai do jetë nëpër klube. Kujtojmë se Getoari nuk ka qenë dhe aq produktiv me projekte muzikore, megjithatë urojmë që viti tjetër të jetë edhe më i suksesshëm për të.



## Luana Vjollca ndan me fansat lajmin e hidhur

Moderatorja e njohur shqiptare ka dhënë një lajm të hidhur për ndjekësit e saj. Luana ka premtuar se do të sillte sot këngën më të re "Gyle Gyle". Pavarësisht përpjekjeve, ajo ka treguar se nuk ka mundur të sjellë në kohë projektin e saj muzikor. "Miq u mundova shumë që ta sillja këtë projekt në këtë fundvit, e pavarësisht dëshirës së madhe, koha nuk më premtoi. Ndaj duke ju kërkuar ndjesë, ju lajmëroj që kënga do të shtyhet për një moment të dytë. Po punoj ndoshta më fort seç mund ta përballoj... por ju premtoj që shumë shpejt ju presin surpriza shumë të bukura! Faleminderit për mbështetjen tuaj përhërë, me ju në krah do ia dal gjithmonë!", ka shkruar në postim Luana.



## U përfol për ndërhyrjen në trup, Big Mama më në formë se kurrë

Artistja nga Maqedonia, Big Mama, ka kohë që nuk ka sjellë ndonjë projekt muzikor, por vetëm ka sjellë imazhe në profilin e saj në "Instagram". Ndryshimi në pamjen e saj ka bërë që Big Mama të jetë në mesin e personazheve më të komentuar përgjatë këtij viti për shkak të ndërhyrjes që bëri në trup. Format që ka arritur dhe kujdesi ndaj pamjes e bën dita-ditës më elegante këngëtaresh shqiptare nga Maqedonia, madje ky ndryshim e sharm vërehet më së miri tek fotografia e fundit e saj, ku bie në sy fustani i shkurtër dhe ekspozimi i këmbëve të saj të holla.



## E kemi pritur, rikthehet në ekran moderatorja e njohur

Pas shkëputjes së gjatë, moderatorja e njohur ka vendosur t'i rikthehet ekranit. Nëpërmjet një postimi të bërë në "Instagram", Elona Duro ka njoftuar se do i kthehet dashurisë së saj të vjetër. Bëhet fjalë për një emision të ri në "Digitalb", i cili mban emrin "Tag". Moderatorja ka zbuluar se programi do të jetë argëtues me të ftuar, biseda, thashetheme, kuize dhe lojëra nëpërmjet telefonatave. Momentalist Elona është drejtuese edhe në një program në "Top Albania Radio".



## Seldi në shoqërinë e një vajze bionde? Ja çfarë fshihet mbas fotos së tyre

Artisti nga Shqipëria, Seldi Qalieu, gjatë vitit 2018 ishte i përfolur në mediet Arozë për ndarjen me artisten nga Kosova, Mimoza Shkodra. Ai ka kohë që po punon për projektin e ri muzikor dhe tani më në fund e ka zbuluar titullin e tij. Më në fund Seldi ka zbuluar për të gjithë fansat e tij një postim të një fotografi në "Instagram" për projektin e tij ku shfaqet me një biondine mjaft seksi. Projekti i tij titullohet "S'ka dashni", por siç shihet nga postimi i Seldit, projektin do ta sjellë edhe me videoklip, pjesë e së cilës do të jetë një biondine joshëse. Ai e ka shkruar në postimin e tij "S'ka dashni", shumë shpejt".



ROMANI


# STEFAN ÇAPALIKU

## Një Shqipëri e kredhur në paradoks

Nga Josif Papagjoni

Kur kam lexuar librat me kujtime "Retë dhe gurët" të Petro Markos, sidomos "Trego për të jetuar" të Garsia Markesit, më shumë jam tronditur, turbulluar dhe ngazëllyer nga jeta e këtyre dy "apostujve" të letrave dhe shpirtit njerëzor, atij shqiptar tek i pari dhe atij kolumbian tek i dyti, se sa nga librat e tyre - kaq të fuqishme ishin mbresat. Ato ishin romane mbi romane, një lloj letërsie e veçantë: edhe jetë e njëmendët, edhe rëfëm i bukur letrar; edhe letërsi, edhe përtej letërsisë. Veç një cipe e hollë e ndante kësi rasti letërsinë dhe trillin nga jeta dhe e vërteta. Por ja ku ia mbërriti edhe ciklli i romaneve "Secili çmendet sipas mënyrës së vet", në tre vëllime, i Stefan Çapalikut, koleg dhe mik i imi i hershëm; roman i kompozuar si në formë kujtimesh e reminiscencash, copë pas cope, kur koha, hapësira dhe mjedisi real historik i Shqipërisë sonë në ngërc e përjaudhë, jep e merr me ligjësi dhe specifikat e të shkruarit letërsi. Veçse tashmë Stefani e bën një të tërë të sajuarën dhe të përjetuarën, ani pse janë ujëra të ndryshme; faktet, ngjarjet, bëmat, personazhet ecejaken në një trajtë mirëfilli romanore. Kam folur për dy romanet e parë, ja ku Çapaliku më dhuroi edhe të tretin, i porsa nxjerrë nga "furrat" autoriale dhe misteret e magmës krijuese.

Kryekreje dua të them se Çapaliku (i biri i Lazrit, siç bën shaka me veten tëndur) është një shkodran i rëkrom, gënësia e tij është e tëra e mbushur me "Shkodër". Dhe pak nga pak ai është bërë nga "i biri i Lazrit", biri i Shkodrës. Dhe më vjen fort mirë për këtë. Stefani është një intelektual i kohës, i kulturuar, komunikues, solidar, për mua edhe i thjeshtë dhe mirënjohës, sidomos burimor në humorin e tij të lindur. Hiqi veskun rrëzëllitës të humorit që gjithë magma subjektore e romanit ka, gjithandëj ti ndjen dashurinë e tij për njerëzit, sidomos Shqipërinë, ashtu të mjerë, të cungët, në baltë, thuajse të marrëzishme dhe të çuditshme, që ai nuk e braktis dot, por shkron e vjen botës, ikin e i vijnë britmat brenda vetes për ta lënë dikur atë, dhe rishtazi e rishtazi ai kthehet e rikthehet në Itakën e vet. Bash kjo dashuri pa zhurmë maskarenjsh, kjo "arsye e mosarsyes", që nuk shpjegohet dot veçse ndjehet sepse është rrenjë e instinkti të tij, për mua është thjesht atdhetaria e pabëzajtë, ashtu siç shumë nga ne bëmë, nuk ikëm, sepse nuk do të ishim vetvetja diku gjatë. Kjo është një integrale qenësore e romanit dhe të menduarit të tij e shkruar në shumë episode, personazhe, bëma;



"Secili çmendet sipas mënyrës së vet" dhe çmenduria kolektive e 1997-ës

është fryma. Mua më ka lënë pa mend pika e vrapit të personazhit të tij, Marketin Saraçi, i gjendur në Amerikë, në Nju Jork, teksa dëgjoji në telefon zërin e prindërve, të gruas, të fëmijëve, ua bëri gradaciela dhe drejt e në aeroportin Xhon Kenedi për të ardhur në atë tokë të përlakur shpirtash të butë, tek fryma dhe aroma e tij: Familja, Atdheu, Shqipëria, Vetvetja.

Ah, kjo Shqipëri "koniciane" (Më ke bir e të kam njerë, Shqipëri të kam dhjerë...). Çapaliku ka sjellë një Shqipëri të katandisur kockë e lëkurë, si pjellë e shtirë e kohës, kur katastrofa dhe goja e zezë e urisë bluante gjer edhe ëndrën gënjeshtare të mëngjesit. Një Shqipëri e brakti-

### RRËNOJAT

Një Shqipëri me rrënoja fabrikash e uzinash si pas një tërmeti, fytyra të parruara, anije të mbushura natën me emigrantë, rrugë me gropa dhe (çfarë marrëzie e "bukur!") një tren i shqyer që lëshohej tatëpjetës së Mamurrasit me motor të fikur dhe shtypte tufën e deleve të gjora, duke i mbushur vagonët me xhamat e thyer përplot me lesh. Një Shqipëri... Ah, moj Shqipëri e gënjyer nga rrenat dhe diplomacitë e të kamurve, nga padurimi i shpresës së vonuar dhe ironia e varfërisë, nga iluzioni që truri i të vobektit prodhon për pallatet e xhamata dhe lugët e florinjta. Dhe prej

sur, që rrekej të mbahej nga iluzioni i "Çekut të bardhë", utopi dhe gënjeshtrë e bukur për të ushqyer barktha të me ndoca shpresa që mos t'ia hiqnin me plumb kokës, që ngazëllehej më tutje prej një slogani politik propagandistik të sekretarit të SHBA, Xhejms Bejkerit, "Freedom works" (liria punon), të kthyer në qasje ironike. Një Shqipëri kur ti, shpresëmbushur po shkoje me gruan tënde shtazënë drejt apartamentit që e kishe ndërtuar me duart e tua me "punë vullnetare", dhe ndërsa mbërrin aty, tullat krejt t'i kanë vjedhur. Kanë mbetur veçse shtyllat e betonit dhe hapësira e zbrazët, një gërmadhë, kësaj here si shenja e një kohe pa kohë, e një barku që gëlltiste vetveten nga uria, hajnia, idiotësia dhe varfëria. Një Shqipëri me rrënoja fabrikash e uzinash si pas një tërmeti, fytyra të parruara, anije të mbushura natën me emigrantë, rrugë me gropa dhe (çfarë marrëzie e "bukur!") një tren i shqyer që lëshohej tatëpjetës së Mamurrasit me motor të fikur dhe shtypte tufën e deleve të gjora, duke i mbushur vagonët me xhamat e thyer përplot me lesh. Një Shqipëri... Ah, moj Shqipëri e gënjyer nga rrenat dhe diplomacitë e të kamurve, nga padurimi i shpresës së vonuar dhe ironia e varfërisë, nga iluzioni që truri i të vobektit prodhon për pallatet e xhamata dhe lugët e florinjta. Dhe prej

**1997**  
Po pse ky vit, viti 1997, ia bujti kryeneç në Shqipëri? Sepse Liria kishte punuar ligisht, shtrembër, jo në hullitë e saj, por kithtazi. Sepse e vërteta ishte fshehur dhe politika shiste iluzione. Se Shqipërisë sonë i munguan liderët mendjehapur, njerëzorë e shpirtmirë, përkundraz i mbush nga gjithfarë morrash e shushunjash, gjithfarë sharlatanësh e "lahutarësh" kokëfortë,

kësaj Shqipërie të shëmtuar, e bukura Shqipëria jonë, kanë ikur shumë kurbetit e shumë të tjerë kanë mbetur aty, ja ashtu, me shpresën ndezur ende mendjes, me një kokërr vezë e pak djathë me mësuesish në shkolla fshatrash të humbura, me pak raki e dy kokrra ullinj, ose verën e kthyer në uthull (simbolikë e gjetur), duke përtypur e ripërtypur befasitë dhe thagmat e kohës se re, dëng me farfuri të ardhura nga larg e ca më shumë me ato që ndodhin në qerthullin tonë të njëmijë e një çudirave. Një Shqipëri që shkron e mbleh nxënësit me maleve për 1 shtator teksa kullosin dhitë e delet, që pret me ankt lajme nga bijtë e malluar shpërndarë botës mbi një fije telefoni, bijtë e arratisur kamionëve mbushur me lëkurë të qelbura apo

të tjerë që sfidonin me kokëkrisjet e tyre vdekjen; një Shqipëri që botonte poetin hermetik italian, Ungareti, mbetur i pashitur në shtëpinë e përkthyesit, ndërsa pronarja e shtëpisë botuese e pandehte si hungarez (Ungareti-Hungary); që provon artin vizual absurd në një shtëpi që mban lopë, vendi i çudive që ndalon trenat për të shitur bido në qumështit të katundarëve. Pastaj Tirana e kioskëzuar gjithandëj.

Detaj fantastik është kur fotografi, miku i autorit, shkrep gjithandëj fotot e dasmës së tij, por, o Zot, ai na paskesh harruar të fuste në aparat shiritin e film-it?! Ose kur një bukunist, gjoja përkthyes, për të fituar ndërron titujt e romaneve të njohur të përkthyer më parë nga mjeshtrit e kësaj zeje sqimatore dhe shënonte emrin e tij si përkthyes. Ca më tej një gazetar televizioni që zë radhë tek ambasada italiane për të tjerët, në këmbim të parave. Edhe kur një dekan fakulteti, me anglishten e çallë, rrekej ta përkthente si në shqip idiomën "Të ndash shapin nga sheqeri", dhe atëbotë rezultonte lezetshëm kështu: "To separate suger... from the shap...!!!"

Kjo Shqipëri e mbyllur si në stallë, e fillim viteve '90, përmes syrit të S. Çapalikut ja tek na hapet së fundmi drejt botës. Hapet apo shqyhet? Dhe rishtazi të vjen në mendje dyfjalëshi i Xhejms Bejkerit: "Liria punon". Po, liria punon për të ndershtmit, për të mirën, për mirëqenien, për lëvizjen e lirë, por botën, për punën. Por liria punonte edhe për gjithfarë vemjesh e zvarranikësh që Shqipëria e ngurtë postkomuniste i nxori saora mbi syprinë, horra e vagabondë që shfrytëzonin gocat e reja të rrëmbyera e të kthyer në prostituta, hajdutë shtëpish dhe kriminelë, njerëz të skutave dhe qelbit njerëzor. Pastaj aq shumë njerëz të papunë që mbushnin klubet, syboshtë, apo burra të trallisuar që shihnin natën kolektivisht videoporno, me sytë gjithë eph, duke shfryrë urinë seksuale e duke lënë në shtretërit e ftohtë të tyre të lodhura. E ky zhgan hajnash e maskarenjsh që Shqipëria i nxori nga anusi i "Freedom works" ishte turpi i saj, emblema e drejtë që krijoi imazhin e keq, atë që edhe sot na ndjek pas e na shajnon, na turpëron, na çmend, na poshtëron, na fyen e na revoltin. Kjo skotizim nga bijtë e malluar shpërndarë botës mbi një fije telefoni, bijtë e arratisur kamionëve mbushur me lëkurë të qelbura apo



**ARQIPESHKVI DREJT XHAMISË**

Mes krismave e gjëmimeve të armëve të mëdha, të frikshme, mes marrëzisë kolektive, i madhi i kishës katolike të Shkodrës, Arkipeshkvi, imzot Frano Ili, nisur nga instinkti i tij prej bariu, çapon drejt xhamisë së qytetit. Po përse? Cili është misioni i tij, cili që kumti që ai mbante thëllë në zemër për t'ia thënë grigjës?

vertimesh, varfërisht e prapambetjesh. Instinkti ynë ishte zvjerdhur. Autori nuk i thotë drejtpërdrejt këto, por gjithçka është e nënkuptuar në ligjërimin e tij, aty në nënshtrësën semantike të romanit.

Shoqëria e fillim viteve '90 në faqet e romanit vjen prorre e traumatizuar, një ndryshim rrënjësor shoqëruar me stres, pabarazi, ndryshim statusi social dhe ekonomik, keqkuptime të lirisë dhe demokracisë, utopitë renaçake të "Çekut të bardhë", spikamat e cinizimit dhe pafytyrësisë, poshtërimi i të varfrit dhe të pambrojturit, qoftë për të lexuar edhe dy libra shkollë; shoqëri mbushur me pijanecë dhe bjerrakohës, rrumpallë që po zbriste teposhtë të ngjarjet që do ta kthenin me bythë përpjetë Shqipërizën tonë të

**ROMANI**

Çapaliku ka sjellë një Shqipëri të katandisur kockë e lëkurë, si pjellë e shtirë e kohës, kur katastrofa dhe goja e zezë e urisë bluante gjer edhe ëndrën gënjeshtare të mëngjesit

gjorë në '97-ën. Por krahas e përkundër këtij llomi që atdheu ynë e qiti në ditët e vështira, spërndriten edhe njerëz të vetëdijës e shpirtit hyjnor, vezullonjës brilante humane në heshlinë, përkorjen dhe modestinë e tyre, siç me një përshkrim emocional Çapaliku sjell vdekjen e poetit Zef Zorba, ahtin e mbetur zemrës që s'e mbërriti dot në gjallje dhe fjalën e fundit në varrimin e tij me leximin e vargjeve aq të trishta, aq prekëse dhe habitshëm aq gjejëse për atë ditë moriti të poetit... Ose i veçanti dhe i jash-tëzakonshmi poet Frederik Resh-pja, që na ishte bërë biznesmen me dy badigardë dhe shtëpi dykatëshe, me begati, piçe, vajza punëtore të shtypshkronjës, diçka që s'ta priste mendja për natyrën boheme të tij. Më tutje përkthyesi i famshëm i Iliadës së Homerit, Gjeorgjikave të Virgjilit, Lukrecit, Këngëve të Rolandit etj., Gjon Shllaku, xhaxhai i Primo dhe Bruno Shllakut, ja ku qiste nga hiri i shekujve edhe 7 dramat e Sofokliut...

E tërë kjo megahistori a yllësi episodesh, ashtu si përroskat që

turren pjerrinave të malit dhe bashkohen në përrën timeri dhe pastaj në lumin e rrëmbyeshëm, ashtu dhe historizat e këtij libri, paçka se ngajjnë si më vete, ngjshen e ngjshen duke vrapuar atje, te vija fatale: Çmenduria kolektive e 1997-ës. Dhe ja ku ia beh para syve gremina, ashtu e befte, tmerruese, tekta ujërat shakullijnë, shkumë-zojnë, bien në theqafje, përthyhen në mijëra stërkalë, dhe krijojnë një drithërimë: tragjedinë kombëtare, kur plumbat shponin qiejt dhe zemrat, ku vdekja dhe marrëzia qenë bërë bashkë, ku gënjeshtra dhe iluzionet kishin rënë kryengulthi dhe gjëma ulërinte në çdo familje, duke i bërë nënat të shtrengonin fëmijët në gjokset e tyre dhe baballarët e vëllezërit të shtinin si të marrë me kal-lash natën, për të treguar se shtëpia kishte zot. Po pse ky vit, viti 1997, ia bujti kryeneç në Shqipëri? Sepse Liria kishte punuar ligisht, shtrembër, jo në hullitë e saj, por kithtazi. Sepse e vërteta ishte fshehur dhe politika shiste iluzione. Se Shqipërisë sonë i munguan liderët mendjehapur, njerëzorë e shpirtmirë, përkundraz i mbush nga gjithfarë morrash e shushunjash, gjithfarë shar-latanësh e "lahutarësh" kokëfortë, që i frynin dasive, përçarjes, urretjeve, pabarazisë, klanit, për ego dhe pushtet personal.

Dhe romani ka një mbyllje që bën bashkë tragjikën dhe madhështoren. Mes krismave e gjëmimeve të armëve të mëdha, të frikshme, mes marrëzisë kolektive, i madhi i kishës katolike të Shkodrës, Arkipeshkvi, imzot Frano Ili, nisur nga instinkti i tij prej bariu, çapon drejt xhamisë së qytetit. Po përse? Cili është misioni i tij, cili që kumti që ai mbante thëllë në zemër për t'ia thënë grigjës? Mos vallë se njerëz të ligj, pjella të Satanit, donin ta hidhnin xhaminë në erë dhe pastaj ta ndiznin gjithë Shqipërinë flakë, të krishterë e myslimanë në luftën vëllavrasëse, për ta shuar me tërësej? "Nuk due me besue se njerëzit janë të çmendun, - thotë i madhi i kishës katolike, - por ama çmendia asht një sëmundje". Dhe popullin shqiptar e kishte kapur kjo sëmundje, kjo kolerë, kjo marrëzi kolektive. E kishte kafshuar giarpri. Duhej një akt ekzorçizmi për t'i dëbuar dajtë që ishin futur shpirttrave të tyre e për ta qitur helmin jashtë. Ndofa të mençurit dhe paqdashësit e fesë, aty në xhami, do të shtrengonin duart për një besë të re, që grigja njerëzore të qetësohej nga çartja dhe dhëmbët e tërbimit, të paqtohej, të bashkohej dhe t'i dëbon-te demonët e luftës, të dëshpërimet dhe të përçarjes; demonët politikë që kishin nxjerrë dhëmbët e qenit dhe i kërcëllin. Unë kështu e kuptova mesazhin e fundit të romanit "Secili çmendet simbas mënyrës së vet", vëllimi i tretë, i Stefan Çapalikut. Dhe them se kështu është. Intuita s'më gabon...

**MONUMENTI****Përfundon restaurimi i kishës së Shën Thanasit, u shemb nga tërmeti më 2017**

Përfundon restaurimi i Kishës së Shën Thanasit, monument kulture i kategorisë së I-rë, e degraduar prej dekadash nga mosndërrhyret në të si dhe humbjet e pësuar nga tërmeti i vitit 2017. Falë projektit të restaurimit të hartuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, rikthehet në jetë jo vetëm nga ana strukturore por edhe si pjesë e itinerareve të turizmit kulturor.

Projekti i restaurimit, pjesë e programit "Rrugët e Besimit", bëri të mundur konsolidimin e çarjeve në muraturë, ringritjen e kolonave, kupolave dhe qemerëve me strukturë guri, ringritjen e murit anësor në pjesën jugore të kishës, ringritjen e çatisë së kryerjes dhe një sërë sistemimesh të jashtme.

Çfarë ndodhi me kishën? Çatia dhe një pjesë e mureve të bazilikës së Shën Thanasit qenë shembur në dimrin e fillimvitit 2017. Lajmi u mësua në qershor. Atë kohë, Ministria e Kulturës njoftoi se "pavarësisht masave përfurcuese të marra, fatkeqësisht, gjatë tërmetit të fuqishëm të shkurtit 2017 me epiqendër në Janinë, ra një pjesë e çatisë dhe mureve të kishës".

Shtohet se në kishën e Shën Thanasit në Leshnicë janë kryer inspektime dhe ndërhyrje përfurcuese nga DRKK Vlorë, ndërsa gjatë dekadave kjo

kishë ka pësuar degradime të rënda në të gjithë elementët strukturorë përbërës të saj dhe nuk është kryer asnjë ndërhyrje deri në vitin 2014. Më herët qenë kryer ndërhyrje si: pajantimi i mureve më të rrezikuara, prerja e pemëve të rritura që kishin mbirë mbi kupolën e objektit dhe inxhinierit të rrënjëve në strukturën e objektit, sigurimi i objektit në vijim të heqjes së bimësisë dhe sigurimi i pikturave murale. Në këto kushte IMK dhe DRKK Vlorë hartuan projektin e emergjencës në shkurt 2017 me vlerën 1 milion lekë të reja. Bëhet fjalë për një bazilikë trineshe me kupolë mbi tambur. Ndërtuar në vitin 1797 në fshatin Leshnicë e Poshtme. Është pikturuar nga Llazari dhe nxënësit e tij më 1801.

**Njoftim i shoqërisë Vodafone Albania Sh.A.****Të nderuar klientë,**

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **07.01.2019:**

Paketa e lidhjes Vodafone Club me çmim shitjeje **800 Lekë** me **TVSH** do të përbajë **300 Lekë** kredit fillestar të vlefshëm për **12 muaj** si dhe **500 SMS** drejt rrjetit Vodafone të vlefshme për 14 ditë.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni [vodafone.al](http://vodafone.al) ose dyqanet Vodafone.



**Kundër rritjes së çmimit të naftës, arrestohen 4.340 protestuese**

**Tentojnë të hyjnë ilegalisht nga Franca duke rrezikuar jetën, kapen nëntë persona me gomone**

Zyrtarët britanikë thanë ditën e djeshme se kanë arrestuar nëntë emigrantë në një plazh në juglindje të Anglisë, të cilët kishin kaluar kanalën e La Mansh nga Franca me një gomone. Nuk raportohet për ndonjë emigrant të ndaluar nga Shqipëria. Ministria e Brendshme tha se bëhet fjalë për pesë burra, një grua, dy djem dhe një vajzë. Ata u



pikasën dhe u kapën nga një anije lokale e shpëtim-it në zonën bregdetare angleze të Kentit. Pas ndalimit, autoritetet raportuan se anija në të cilën u udhëtonin nëntë emigrantët kish-te një kapacitet të vogël duke vënë kështu seriozisht në rrezik jetën e tyre. Ndërkohë mediat britanike raportojnë se po zhvillohen edhe operacione të

tjera për të ndaluar gomone të mbushura me emigrantë, të cilët po mësyjnë Mbretërinë e Bashkuar nga Franca. Sipas të dhënave të siguruar nga autoritetet thuhet se përgjatë Krishtlindjeve rreth 43 emigrantët kanë tentuar të kalojnë në mënyrë ilegale drejt Anglisë, veprim ky i cili mund të kishte marrë shumë jetë njerëzish.

Ministria e Ekonomisë: 28 milionë euro dëme materiale për shkak të 'jelekëverdheve'

Vijojnë ende protestat në Francë për shkak të 'jelekëverdheve'. Nga ana tjetër ka arritur rreth 43,000 njerëz mbeten pa punë për shkak të protestave që filluan më 17 nëntor. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, shumë kompani kanë pësuar dëme të mëdha materiale për shkak të protestave të vazhdueshme. Dëmet që i janë shkaktuar shtetit vlerësohen të jenë rreth 28 milionë euro. Gjatë protestës, 10 persona vdiqën dhe rreth 1,000 u plagosën ndërkaq u arrestuar rreth 4.340 njerëz. Protestat antiqeveritare të "jelekë verdhët" kanë ndikuar në shumë të rritjes ekonomike si dhe mungesën e sigurisë së bizneseve. Lëvizja "jelekëverdhtë" mban emrin sipas xhaketa të sigurisë, të cilat duhet t'i posedojnë të gjithë shoferët në Francë. Protestat filluan në mesin e nëntorit dhe u nxitën nga një rritje e tarifës për karburante. Protestat dhe bllokimi i rrugëve në rrethrotullime në Francë po vazhdon pasi protestuesit kanë thënë se masat e marra nga presidenti francez nuk

**Protestat në Francë, mbeten pa punë 43,000 njerëz**

*Kundër rritjes së çmimit të naftës, arrestohen 4.340 protestues*



janë të mjaftueshme për ta shuar zemërimin e tyre dhe për ta ndaluar kundërshtimin ndaj padrejtësisë sociale. Protestuesit antiqeveritarë kanë bërë thirrje për vazhdim të protestave në Paris, pasi deri më tani janë mbajtur protesta të tilla gjatë katër fundjavave të kaluara, në të cilat kishte dhunë në Paris dhe qytete tjera. Këto protesta e kanë futur qeverisjen e Makronit në krizën e saj më të madhe që prej kohës kur erdhi në pushtet. Makroni doli me një deklaratë në televizione, përmes së cilës njoftoi për masat që i ka marrë për ta zbutur pakënaqësinë e protestuesve. Ai tha se paga minimale do të rritet për 100 euro më shumë, ndërsa do të anulohet taksë për pensionet që janë nën dymijë euro. Sidoqoftë, ai nuk njoftoi për ndonjë hap lidhur me politikën tregtare. Ai vazhdon të qëndrojë prapa vendimit për taksë të përgjysmuar për të pasurit, ndërsa protestuesit po kërkojnë që ndaj tyre të zbatohet një taksë e plotë, shkruan "The Guardian". Drejtori i shërbimeve inteligjente të brendshme të Francës, Laurent Nunez ka deklaruar se numri i "jelekëve të verdhë" të ndaluar në gjithë shtetin është rritur në 700. Nunez në një deklaratë për televizionin e Francës 2 ka thënë se në protesta kanë marrë pjesë 31 mijë persona nga i

gjithë shteti. Ai tha se në protesta janë ndaluar më shumë se 700 persona nga e gjithë Franca. Kryeministri francez Eduard Filip është zotuar se do t'i rikthejë vendit unitetin kombëtar pas dhunës që shpërtheu gjatë fundjavës së katër të protestave të jelekëve të verdhë. Policia përdori gaz lotsjellës dhe plumba gome gjatë demonstratave të së shtunës ku jelekët e verdhë protestuan kundër rritjes së çmimit të karburanteve dhe kostove të larta të jetesës. Më shumë se 1700 persona u arrestuan, por dhuna nuk ishte në nivelet e një jave më parë. Kryeministri francez tha se duhet të vijojnë diskutimet me protestuesit paqësore. "Asnjë taksë nuk duhet të vërë në rrezik unitetin tonë kombëtar. Duhet t'i hapim rrugë rindërtimit të këtij uniteti përmes dialogut, punës dhe bashkimit" u shpreh Filip. Sipas tij presidenti Emanuel Makron, të cilit shumë protestues i kërkuan që të dorëheqej, do të paraqiste së shpejti masa për të promovuar dialogun. Ndërkohë, ministri i Brendshëm Kristof Kastaner vlerësoi forcat e policisë që sipas tij ia kanë dalë të përbajnë pjesën më të madhe të trazirave. Në një postim në "Twitter" mbrëmjen e së shtunës, edhe presidenti Makron falënderoi forcat e sigurisë për kurajën dhe profesionalizmin e jashtëzakonshëm që kanë treguar.

**SHKURT**

**SHBA, Trump mund të bllokojë telefonat celularë 'Huawei'**

Donald Trump po shqyrton mundësinë për të bllokuar hyrjen në SHBA të telefonave Huawei. Reuters raporton se kjo do të bëhet përmes një urdhri ekzekutiv që do të ndalojë kompanitë amerikane të përdorin pajisjet e telekomunikacionit të bëra nga kompania kineze Huawei, por edhe ZTE, në tjetër kompani me bazë në Kinë. SHBA pretendon se këto dy kompani që prodhojnë pajisje telekomunikacioni punojnë me urdhra të qeverisë kineze dhe pajisjet e tyre mund të përdoren për të spiunuar amerikanët. Urdhri ekzekutiv që do të ndalojë futjen e këtyre pajisjeve në tregun amerikan mund të nxirret në muajin janar 2019. Urdhri do të kategorizohet si emergjencë kombëtare që kërcënon SHBA-në. Dy kompanitë kineze, Huawei dhe ZTE në të kaluarën kanë mohuar akuzat që pajisjet e tyre përdoren për të spiunuar.

**Gjermani, arrestohen katër të dyshuar për terrorizëm**

Katër persona u arrestuan në Gjermani me dyshimin e planifikimit të një sulmi terrorist, të cilët mohuan përfshirjen e tyre, theksoi zëdhënësi i prokurorisë në Karlsruhe. Tre burrat dhe një grua po hetohen, pasi dyshohen se po përgatishnin një akt të rëndë dhune, ku gjatë kontrollit u konfiskua një armë tip "Kalashnikov", në Plankstadt, pranë Heidelbergut. Një grua 39-vjeçare dhe dy burra të moshës 33 dhe 49 vjeç u arrestuan pasi policia kontrolloi pronat në Mannheim në rajonin Rhine-Neckar, ndërsa një 53-vjeçar u arrestua në aeroportin e Frankfurtit. Ai mendohet të jetë vëllai i 49-vjeçarit.

**Turqi, pezullohen programet televizive që kritikojnë Erdogan**

Autoriteti transmetues i Turqisë, RTUK, pezulloi dy programe televizive kritikë ndaj presidentit Rexhep Tajip Erdogan, raportoi e përditshma turke "Hurriyet". Transmetuesi kritik i qeverisë "Halk TV" pezulloi pesë here një shfaqje, ndërsa një program lajmesh në televizionin Fox TV nuk do të transmetohej për tre ditë, citoi "Hurriyet" duke përmendur vendimin e RTUK. Të dy këta transmetues u gjobitën. Fatih Portakal, prezantues i Fox TV kritikoi presionin ndaj opozitës duke argumentuar se njerëzit nuk guxojnë të protestojnë paqësisht as për rritjen e çmimit të gazit. "Njihni kufijtë tuaj, besoj se gjykata do t'u japë këtyre njerëzve një mësim", kërcënoi Erdogan. Dy aktorë të shquar të komedisë, Metin Akpinar dhe Mujdat Gezen, u shfaqën në një emision në "Halk TV" më 21 dhjetor, duke kritikuar atë që ata e quajten mungesa e demokracisë në Turqi.

**INDONEZI, POLICIA DJEG NJË "MAL" ME MARIJUANË**

Policia indoneziane shkrumboi një "piramidë" prej 800 kilogramësh marijuanë duke e demonstruar në mënyrë spektakolare asgjësimin e kësaj droge të paligjshme. Autoritetet e provincës Aceh, në veriperëndim të këtij shteti me shumicë myslimane, shkatërruan qindra paketime me marijuanë si dhe 19 kilogram metamfetaminë të sekuestruar këtë vit nga policia.



**FOTOLAJM**



*Proveni të mos e prekni vazhdimisht fytyrën. Personat të cilët për arsye pune qëndrojnë shumë kohë në telefon janë subjekt i akneve në zonën e mjekrës. Gjithashtu, është shkak traume për aknet, njësoj sikur i shtrydh.*



**K**ur jeni të rritur, habiteni që u kthyen përsëri. Për fat të mirë, trajtimi i akneve në dhjetëvjeçarët e fundit është përmirësuar, dhe prandaj është më i thjeshtë kurimi i tyre.

Faktor vendimtar është gjeni. Me fjalë të tjera, mund të trashëgohen karakteristikat e lëkurës dhe kështu edhe predispozita për akne. Lëkura e fytyrës, kraharorit dhe e shpinës ka mijëra gjëndra yndyre, të cilat lubrifikojnë duke prodhuar yndyrën. Ekzistojnë 1000 gjëndra yndyre për centimetër kub në pjesën qendrore të fytyrës. Yndyra e gjëdrave kalon nëpërmjet kapilarëve të hollë deri në sipërfaqe të lëkurës.

Ndonjëherë, këto bllokohen nga yndyra, bakteret dhe qelizat e vdekura, duke prodhuar si pasojë aknet. Kjo dukuri duket më e hasur gjatë adoleshencës, për shkak të ndryshimit të nivelit të hormoneve, të cilat rrisin gjëndrat e yndyrës dhe i stimulojnë ato, duke prodhuar një dozë më të madhe të kësaj substance yndyrore. Në përgjithësi kjo situatë normalizohet rreth të njëzetave. Atëherë, përse aknet zhvillohen tek të rriturit mbi 20 vjeç? Ka arsye të ndryshme, mes të cilave:

Hormonet. Aknet premenstruale janë të vërteta. Shtatzënia, ndryshimet gjatë ciklit menstrual dhe pilula anti-baby mund të shkaktojnë ndryshime të nivelit të hormoneve dhe si rrjedhojë, shfaqjen e akneve të gratë. Për disa, kontrceptivët në dozë të vogël të marrë nga goja, mund të ndihmojnë për zvogëlimin e këtij problemi; për të tjera, ato mund t'i shpëtojnë. Nëse keni akne dhe çrregullime të ciklit menstrual, këshillohet të konsultohet mjeku për të kuptuar nëse shkak është një nivel anormal i hormoneve.

Stresi. Dermatologët kanë të njëjtin mendim për sa i përket faktit që stresi i madh mund të ndryshojë nivelin e hormoneve.

Produktet kozmetike. Produktet për trukun e fytyrës, nëse janë më përmbajtje të lartë vajore, mund të bllokohen poret dhe të shkaktojnë kështu aknet.

Vendi i punës. Nëse punoni si mekanik apo në kuzhinë, fytyra mund të jetë e sulmuar nga vajrat, disa prej të cilëve mund të provokojnë akne. I njëjti efekt

mund të arrihet duke qenë në kontakt me produkte kimike.

Medikamente të caktuara. Disa medikamente, si Dilantin (i cili përdoret në kurimin e epilepsisë), mund të provokojnë akne.

Faktorët të cilët shkaktojnë akne janë të ndryshëm, por ekzistojnë disa masa efikase të cilat mund të shfrytëzohen për pastrimin e lëkurës.

1. Mos dëmtoni. Me fjalë të tjera, mos i prekni, mos i shtrydhni! Shkatërrimi mbi pore është si një top i vogël. Mund ta pëlçasësh, por nën sipërfaqe yndyra, bakteret dhe qelizat e vdekura të lëkurës mund të depërtojnë në indet rrethuese, duke shkaktuar kështu një inflamacion.

2. Përdorni peroksidin e benzolit. Një numër i madh i produkteve farmaceutike në shitje të lirë përmban këtë përbërës, i cili ndihmon në largimin e grumbullimit të qelizave të vdekura të lëkurës, të yndyrës në pore, dhe për të pakësuar edhe numrin e bakteveve. Filloni me dozën minimale dhe pak nga pak e shtoni, veçanërisht nëse keni lëkurë të ndjeshme, sepse sa më i lartë të jetë përqendrimi i saj, aq më lehtë mund të shkaktohen irritime. Përdoreni një apo dy herë në ditë. Vepron pas afro dy javësh. Lëkura reagon fillimisht me skuqje dhe rënie të qelizave të vdekura, rrallë ndodhin reaksione alergjike. Nëse lëkura thahet shumë, sugjerohet të aplikohet një krem hidratant.

3. Përdorni medikamente edhe për parandalim. Mos përdorni produkte vetëm në vendin problematik me akne. Vendoseni në të gjithë zonën e cila mund të jetë objekt aknesh. Kjo përfshin të gjithë fytyrën, shpinën dhe



## Si të kemi një lëkurë të pastër, pa akne



kraharorin (shmangni zonën e buzëve dhe të syve).

4. Përdorni delikatesë për pastrimin e fytyrës. Shpesh njerëzit me lëkurë të yndyrshme ngulmojnë në larje të shpeshta të fytyrës dhe mendojnë se kështu mund të heqin aknet. Por nuk e arrijnë. Mund ta lash fytyrën dhjetë

herë në ditë dhe përsëri të kesh akne. Nuk ka të bëjë me pastërtinë. Larja është vetëm largimi i yndyrës në sipërfaqe të lëkurës, jo nga kanalizimet e bllokua. Një i rritur mbi 18 vjeç mund të ketë lëkurë të thatë dhe akne njëkohësisht. Në të vërtetë nëse ka një pastrim agresiv, përfundon në tharje apo irritim të pjesëve më të ndjeshme të fytyrës.

5. Kujdes nga produktet vajore. Kjo vlen për produktet vajore për flokët, produktet vajore për lëkurën dhe veçanërisht për pastrimin e fytyrës.

6. Përdorni produkte kozmetike me bazë uji. Nëse produkti është i ndarë në dy shtresa, ujë dhe produkt bazë, është me bazë uji. Nëse nuk është i tillë përmban vaj. Produktet kozmetike për sytë dhe buzët janë të sigurt sepse në përgjithësi nuk ka akne në këto zona.

7. Mos mbështetni mjekrën në dorë. Proveni të mos e prekni vazhdimisht fytyrën. Personat të cilët për arsye pune qëndrojnë shumë kohë në telefon janë subjekt i akneve në zonën e mjekrës. Gjithashtu, është shkak traume për aknet, njësoj sikur i shtrydh.

8. Mbrohuni nga dielli. Dikur besohej se ekspozimi në diell ndihmonte në eliminimin e akneve. Përkundrazi, tepër diell mund të provokojë kancerin e lëkurës dhe plakjen e parakohshme, duke vënë në rrezik avantazhet e saj. Mbrohuni me një krem dielli me faktor mbrojtës minimumi 15.

9. Mos u shqetësoni për dietën. Nuk ka prova që çokollata, të fërguarat dhe produktet të tjera të shkaktojnë akne të rinjtë. Nuk ka rëndësi ajo që konsumohet. Nuk mund t'i jepet faji

çokollatës, arrave apo produkteve të tjera të cilat përmbajnë yndyrna kur shfaqen puçrra në fytyrë. Nëse, përkundrazi, vërehet një lidhje paralele midis një ushqimi të caktuar dhe shpërthimit të puçrrave në fytyrë, shumë dermatologë janë të një mendimi kur këshillojnë të shmangen këto ushqime.

Çfarë mund të bëjë mjeku kundër akneve? Një akne e vazhdueshme mund të ndikojë negativisht në karakterin e njeriut. Mund të ketë pasojë në jetën sociale, psikologjike dhe seksuale të individit që mund të jenë edhe serioze. Këshillohet që të kurohet që në shfaqjen e puçrrave të para në moshë të re, veçanërisht nëse edhe prindërit kanë vuajtur nga akneja akute.

Kur është momenti për të konsultuar me një dermatolog për aknet? Shumë përgjigjen "kur ato ju shqetësojnë". Varet nga si e shikon çdo individ seriozitetin e gjendjes.

- Nëse është përdorur një produkt me peroksid benzoli për gjashtë apo tetë javë dhe nuk zgjidhur ende problemi.

- Nëse ka puçrra të qelbëzuara më të mëdha sesa koka e fijos së shkrepësës.

- Nëse ka noduj në përmasën e mollëzës së gishtit të vogël.

- Nëse ka njolla të mbetura pas akneve.

- Është shumë e rëndësishme vizita te dermatologu përpara se të formohen cicatricet.

Në ditët tona ka një shumëllojshmëri ilaçesh për trajtimin e akneve, të cilat përfshijnë antibiotikët dhe një sërë medikamentesh të quajtur retinoidë.

Opinion

i Ditës

# Dy fjalë për katër lëvizje diplomatike greke

Nga Jorgji Kote

... me sekretarin Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, ministri Alternativ i Punëve të Jashtme, Georgios Katragoulis nënshkroi në Uashington dokumentin dypalësh "Dialogu strategjik". Ai mbështetet në pesë shtylla kryesore: bashkëpunimi rajonal, mbrojtja dhe siguria, zbatim i ligjit & lufta kundër terrorizmit, energjetika & investimet dhe kontaktet njerëzore.

Siç është nënvizuar edhe nga analistët, këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë lëvizje historike, siç ishte vizita e ish-Presidentit Clinton në Athinë më 1999 dhe pak vite më vonë lançimi i Planit grek për Rindërtimin e Ballkanit Perëndimor prej 500 milion dollarë; dihet se në ato vite, ish-kryeministri George Papandreu shpalli edhe objektivin për anëtarësimin e vendeve të rajonit në BE brenda vitit 2014. Ndonëse i ekzagjeruar, bashkë me Samitin e Selanikut më 2003, ky objektivi shërbeu si nxitje dhe inkurajim i madh për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Gjithsesi, ky "Dialogu Strategjik" shënon një moment cilësor në politikën dhe diplomacinë greke, rrjedhojë kjo edhe e realiteteve të reja gjeopolitike në Greqi, Ballkan, Evropë dhe më gjerë; plasaritjet e mëparshme turko-amerikane, roli në rritje i Rusisë dhe Turqisë në Ballkan etj., e kanë nxjerrë më në pah rolin grek në këtë rajon të trazuar. Me dallimin se 15 vjet më parë Greqia pretendonte të ishte "forca lëvizëse", ndërsa tani "stabilizator rajonal". Veç të tjerash, ngritja e "stekës" diplomatike greke është dhe rezultat i vlerësimit ndërkombëtar të Marrëveshjes së Prespës për emrin e Maqedoninë, ftesën së saj për SHBA si i ftuar nderi në Panairin Ndërkombëtar të Selanikut dhe një sërë projektesh të tjera jetike ekonomike dhe tregtare.

Ndërsa më 19 dhjetor, Presidenti i Greqisë, Prokopis Pavlopoulos bëri një vizitë zyrtare në Bruksel. Ai zhvilloi bisedime me Presidentin e Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, drekoi me Kolegjin e Komisionerëve etj. Kjo ishte vizita e parë e një presidenti grek në Bruksel nga viti 1981 kur Greqia aderoi në BE.

Me këtë rast, ra në sy atmosfera tejtejt miqësore plot me komplimente reciproke, si kompensim i viteve të mëparshme të mbushura me mëllef dhe etiketime.

Me një tiradë lëvdatash, presidenti grek e konsideroi Junckerin "shpëtimtar të anijes evropiane dhe mik të popullit grek në kohët e saj më të vështira". Natyrisht që dhe Junckeri tregoi reciprocitetin e tij bujar me shumë vlerësime për arritjet greke. Edhe "kumbari" i kësaj vizite, komisioneri grek Avramopoulos nuk mbeti pas me lavdeve për të dy presidentët, kur ai po lobon për t'u konfirmuar në postin e tanishëm ose dhe në një



tjetër pas zgjedhjeve evropiane më 26 maj 2019.

Veç aspektit dypalësh, në Bruksel u fol goxha edhe për të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor: Pavlopoulos veçoi respektimin e së drejtës ndërkombëtare dhe të historisë si kushte të vetme që "dyert e BE-së të mbeten të hapura" për Maqedoninë dhe vendet e tjera. Ndonëse Juncker theksoi se është në favor të zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor, sipas tij ky proces do të kërkojë kohë të gjatë. Ai përsëriti zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe problemeve kufitare si kusht të domosdoshëm përpara përcaktimit të kalendarit kohor të anëtarësimin në BE. Sipas tij, kjo është e nevojshme që destabiliteti dhe deficitet demokratike në vendet e rajonit të mos transferohen në BE.

Lëvizja e tretë diplomatike greke ishte Samiti i Katërshes - Greqi, Serbi, Bullgari dhe Rumania, më 22 dhjetor në Beograd, ku Rumania, e cila më 1 janar merr presidençën e radhës së BE-së, premtori bashkë me Greqinë dhe Bullgarinë mbështetjen e hapur për Serbinë për anëtarësimin në BE.

Ky grupim që është "ngjizur" katër herë më parë e u Greqia luan rolin e "violines së parë" duket se synon të jetë kundrapeshë ndaj Grupit të Visegradit, Benelux, vendeve nordike etj., në peizazhin e ri që po konturohet në gjirin e BE-së. Njëpërmjet tij, Greqia synon të zgjerojë gjeografinë politike të ndikimit të saj brenda BE-së. Si ai po lobon për t'u konfirmuar në postin e tanishëm ose dhe në një

afrimi i javëve të fundit Turqi-SHBA, pas tërheqjes së trupave amerikane nga Siria dhe vizitës së pritshme të Presidentit Trump në Ankara. Këto zhvillime të reja turko-amerikane, por edhe turko-ruse sinjalizojnë një "behar" të ri diplomatik ndërmjet këtyre tri vendeve të mëdha, duke rrezikuar të zbehin e lenë në hije rolin e politikës dhe diplomacisë greke në rajonin tonë të trazuar.

Së katërti, politika greke, në pushtet dhe në opozitë ka nisur një seri lëvizjesh politike dhe diplomatike, me qëllim të sigurimit të saj me shumë posteve kyçe në institucionet kryesore evropiane pas zgjedhjeve evropiane të 26 maj 2019. Natyrisht, kjo do të jetë në vartësi të fituesve të tyre në Greqi dhe në një plan më të gjerë evropian. Në rasti fitoreje të opozitës, "Nea Demokratia" siç tregojnë sondazhet, lideri i saj Mitsotakis ushqen shpresa të mëdha; kjo pasi ai është ndër mbështetësit kryesorë të gjermanit Manfred Weber, president i Partive Popullore Evropiane dhe kandidati i tyre kryesor si president i Komisionit Evropian. Veç të tjerash, përfillet se Greqia synon të marrë dhe postin e Mogherinit.

Lidhur me lobin e fuqishëm grek në BE, ndër të tjera njoftohet se krahas Komisionerit D. Avramopoulos, ndër personat/lobistët më të fuqishëm në Evropë për "Nea Demokratia" është kryezëdhënësi i Komisionit Evropian, Magaritis Schinas; sikundër bashkëshortja e tij spanjolle, Mercedes Alvarogonzales, shefe e Kabinetit të

Manfred Weber në Parlamentin Evropian.

Pretendime të mëdha ka dhe kryeministri Tsipras, duke përfshirë veten e tij në rast se humbet zgjedhjet në Greqi dhe personalitete të tjera të njohura të majta.

Kësajsoj, Greqia synon të shfrytëzojë koniunkturën e favorshme politike dhe institucionale pas kapërcimit të krizave financiare, Marrëveshjen e Prespës, predispozicionin për zgjidhjen e konfliktit në Qipro dhe moderacionin e Tsipras që po synon të spositoje Syrizen drejt qendrës së majtë, për forcimin e imazhit ndërkombëtar; bashkë me të dhe pozitën e saj në BE, të cilat do t'i jepnin fakte dhe argumente të tjera për promovimin e saj si lider në Ballkanin Perëndimor.

Si diplomat për një kohë të gjatë, e di se diplomacia jonë, por edhe e Kosovës i ndjekin me vëmendje këto lëvizje diplomatike greke, duke bërë vlerësime pozitive së bashku me mësimet dhe përfundimet përkatëse, për një kujdes më të madh në marrëdhëniet me fqinjin tonë. Sidomos tani që ndodhemi në prag të kërkesës për çeljen e negociatave. Duam, s'duam, veç skepticizmit nga vende të tjera, në kushtet e tanishme, ndoshta mund të na duhet të përballemi sërish me një trysni më të madhe e në rritje greke që i gjen/sajon shume lehtë pretekste. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kosovën, ku qëndrimet greke pritet të jenë edhe më të forta kundër saj. Këtë e paralajmëroi vetë Tsipras në takimin me Presidentin serb Vučić më 21 dhjetor

kur tha se "Kosova po i hedh benzinë zjarrit", e duke dënuar ashpër taksën 100 për qind ndaj importeve serbe dhe krijimin e ushtrisë. Ndërkohë që konfirmoi qartë mbështetjen për Serbinë si aleat strategjik, duke e ftuar të jetë dhe në ceremoninë e Marrëveshjes së Prespës. Tsipras foli edhe mbi rrjetin hekurudhor Selanik-Shkup-Beograd-Budapest; kurse për Shqipërinë jo vetëm nuk e tha një fjalë të mirë, por indirekt na kërcënoi me pasojë për "mosrespektim të të drejtave të pakicave greke!"

Faktor tjetër që na shtrëngon të jemi të matur dhe pragmatistë, natyrisht pa humbur kurrësi frymën e parimeve dhe objektivave tona është miratimi dhe nënshkrimi i pritshtëm i Marrëveshjes problematike të Detit; mesa duket, ajo do të jetë për të dyja palët, por sidomos për ne "Shpata e Demokleutit" dhe "Thembra e Akilit". Synimi mbetet që ajo të jetë një marrëveshjeje e drejtë dhe e balancuar, por jo me çdo kusht dhe çmim e ca më pak në dëm të interesave tona. Ndaj, në vend të euforisë së parakohshme, prononcimeve populiste dhe dilentateske kërkohet realizëm, vizion dhe vendosmëri.

Gjithashtu, transparenca me publikun është kërkesa numër një dhe urgjente lidhur me suksesin e këtij operacioni të ndërlikuar dhe delikat. Pa nënvlefësuar konfidencën e nevojshme diplomatike, me të nuk duhet abuzuar, ndryshe mund të kthehet në bumerang e të kompromentojë të gjithë procesin dhe suksesin e pritshtëm.

Po ashtu, në marrëdhëniet me Greqinë, ka shumë vend dhe hapësirë që diplomacia jonë të shfrytëzojë koniunkturën e reja politike, sidomos marrëdhëniet tona me SHBA-të dhe Turqinë si aleatë strategjikë; kështu, nuk do të bëim parë e lëshimeve pa ndonjë rezultat dhe në dëm të kohezionit tonë të brendshëm politik.

Së fundi, në këto kushte dhe rrethana të reja më të favorshme për palën greke, objektivi ynë mbetet që në vend të përplasjeve dhe "gër-vëreve" për interesa të ngushta, të bëjmë maksimumin drejt mirëkuptimit, krijimit të besimit dhe sheshimit të tyre, duke ushqyer vazhdimisht jo vetëm dialogun zyrtar, por pa mbetur "skllëvër" të tij e duke forcur më të gjithë marrëdhëniet miqësore parlamentare, ekonomike, publike dhe njerëzore me Greqinë.

Padyshim, që krahas diplomacisë, qeverisja e mirë, veçanërisht mirëkuptimi dhe konsensusi ndërpartak brenda vendit, që pse ta fshëhim është "për tokë" është kusht vendimtar për qëndrimin konsekuente, solide dhe pa gabime nga ana jonë. Sepse siç thoshte Ish-kryeministri britanik William E. Gladstone: "Parimi i parë për politikën e jashtme është qeverisja e mirë brenda vendit".

Opinioni *i* Ditës

# Sterjo Spasse - Një dhe i pandarë

Nga Ilir META

(vijon nga faqja 1)

... të madh Sterjo Spasse dhe i përgëzoi sinqerisht dy institucionet organizatore, Universitetin 'Fan S. Noli' dhe shoqatën maqedonase 'SONCE'.

Shqipëria ka gjithmonë nevojë të evidentojë përherë e më shumë dhe të vlerësojë personalitetet e artit, kulturës, shkencës, të cilët nëpërmjet veprimtarisë së tyre kanë kapërcyer të zakonshmen dhe të përditshmen.

Sterjo Spasse është pikërisht një personalitet i tillë.

Ai mbetet shkrimtari, publicisti qytetar e intelektual, i cili ka krijuar vëllimin e vet historik dhe bën pjesë në ato figura që i ka dhënë historisë cilësime të veçanta dhe ka marrë prej saj figurën e paharrueshme të një personaliteti gjurmëlënës.

Sterjo Spasse, për nga vlera e krijimtarisë së tij letrare dhe shoqërore mbetet personaliteti me integritet dhe individualitet, me sqimë dhe cilësi mjaft të larta.

Romani i tij i famshëm 'PSE' paralajmëroi krijimin e një letërsie moderne në Shqipëri ndërsa kauza e madhe nëpërmjet kësaj veprë të jashtëzakonshme mbetet prelu-di i subjektit të çlirimit shoqëror me romanin 'Ata nuk ishin vetëm'.

Vepra dhe veprimtaria e tij letrare e ka burimin në traditën, historinë dhe kulturën kombëtare dhe ku spikat virtytet themelore të popullit tonë, që ai, mjeshtërisht i ngriti në vlera arti, nëpërmjet një gjuhë të thjeshtë dhe të pasur dhe nëpërmjet një mendimi të thellë dhe mesazheve të rëndësishme ideore.

Figura e Sterjo Spasses mishëron jo vetëm intelektualin dhe shkrimtarin e spikatur të vendit tonë, por edhe një figurë të pakrahasueshme në nivel ballkanik dhe evropian.

Si bir i shquar i komunitetit maqedonas, Sterjo Spasse u bë frymëzimi dhe ura lidhëse shpirtërore e bashkëpunimit të shqiptarëve dhe maqedonasve.

Jeta, aktiviteti dhe vera e këtij personaliteti të veçantë dhe të shquar është simbioza e përsosur dhe harmonike brenda një njeriu të të dy shoqërive apo popujve në dobi të harmonisë dhe dashurisë.

Ky element spikati veçanërisht në romanet e tij të famshëm 'Zgji-mi' dhe 'Pishtarët', që konsidero-



hen me të drejtë burimi i thellësive ende të paeksplorueshme të ndërkomunikimit ballkanik.

Sterjo Spasse përbën një shembull ekstremisht të gjallë, që u mëson sot politikës, politikanëve dhe shoqërisë se kufijtë nuk duhen shfrytëzuar për ndarje, por si një mundësi për të ndërtuar një bashkëpunim të qëndrueshme nga pikëpamja njerëzore, intelektuale, kulturore dhe ekonomike.

Sterjo Spasse ishte edhe humanist i madh.

Respekti dhe dashuria e tij për origjinën, e gërshetuar me mjedisin e kultivimit të tij intelektual e bënë atë jo vetëm një njeri të respektuar, por edhe shembull për brezat pasardhës të krijesve.

Ai studioi në Elbasan e në Korçë, dy qytetet më të shquara në fushën e arsimit. Punoj dhe dashuroi arsimin në këto qytete, jetoi dhe bashkëpunoi me njerëzit më të ndritur të kulturës sonë kombëtare të kohës dhe u bë protagonist i ajkës së kësaj kulture duke u bërë njëkohësisht proverbial me shumë tituj librash dhe përkufiz-

imesh në romanet e tij epope.

Ndaj unë kam vendosur që këtij intelektual të shquar t'i akordoj sot, në këtë simpozium që mbledhet për nder të tij dhe në qytetin e Korçës, që ai aq shumë e dëshoi dhe e gdhendi në romanet e tij, titullin e lartë 'Kalorës i Urdhrit të Flamurit'.

E përjetshme vepra e tij! Sterjo Spasse do të mbetet gjithmonë një dhe i pandarë!"

Në këtë simpozium shkencor Presidenti i Republikës dekoroi shkrimtarin e shquar Sterjo Spasse (pas vdekjes) me Titullin "Kalorës i Urdhrit të Flamurit": "Në vlerësim të veprës së shquar në letërsinë shqipe, duke frymëzuar me punën e tij vlerat e larta të dinjitetit njerëzor, qytetar, shoqëror e kombëtar. Për veprimtarinë e tij të spikatur edukative dhe intelektuale, rolin e vyer dhe kontributin e tij etno-kulturor në vendin tonë".

Pasi mori në dorëzim dekoratën e lartë, i biri i shkrimtarit, Ilinden Spasse theksoi mes të tjerash se: "Titulli 'Kalorës i Urdhrit të Flamur-

rit' që i jepet Sterjo Spasses nga Presidenti Meta në Korçë, për mua, është një gjetje mjaft e bukur dhe domethënëse, sepse Korça, ka qenë dritarja e parë ku Sterjoja u ndesh me kulturën qytetare, ku ndjeu dorën e ngrohtë të mësuesve të tij të parë, që jo vetëm e mësuan dhe e edukuan, por edhe e orientuan dhe e ndihmuan për të vazhduar më tej në Normalen e Elbasanit.

Por Korça, ashtu siç diti ta frymëzonte e ta nderonte në të gjallë, diti edhe ta ligjërojë, qoftë me lajmet në mediat elektronike, qoftë me shkrimet që botoi në shtypin e saj, ashtu edhe me telegramet e vizitat e shumta ngushëluese që iu bënë familjes së tij.

Nga ana simbolike, Sterjoja që jetë jetën punoi me një përkushtim për edukimin dhe emancipimin e brezave të rinj, janë pikërisht këta breza që tani e vlerësojnë dhe e nderojnë herë pas here sipas rastit nëpër mbledhje të ndryshme jubileare.

Ndaj nga zemra gjithnjë më buron dy fjalëshi: Paleminderit Korça!".

## HOROSKOPI

### DASHI

Disa persona të kësaj shenje duhet të vendosin përfundimisht planet për ditën e Vitit të Ri. Ato do të miratohen menjëherë edhe nga familja juaj, pavarësisht disa ndryshimeve të vogla.

### DEMI

Për disa Demë, kjo ditë do të jetë e mbushur plot shqetësime. Duhet të përgatiteni për disa evente, të cilat do të vijnë njëra pas tjetrës, duke marrë parasysh që po afrohet festa e fundvitit. Gjithçka do të rrihtë pozitivisht, ndaj edhe në mbrëmje nuk do të ndiheni aspak të lodhur.

### BINJAKET

Ka gjasa të takoheni me një person me të cilin ndani shumë kujtime. Mund të merrni një dhuratë shumë të veçantë nga ish partneri juaj. Në mbrëmje do t'i përkushtoheni shumë vetes.

### GAFORJA

Disa prej jush që pretendoni rritje në pozicion nuk jeni të destinuar për ta përfutur një gjë të tillë. Ka gjasa ta përfundoni këtë vit identik siç e nisët. Përpuniqni të mendoni mënyrën për t'u rritur profesionalisht. Lëroni partnerin/partneren tuaj të vendosë vetë se çdo të bëjë me lidhjen në vijim.

### LUANI

Dikush do të përpigjet t'ju bëjë një kompliment ose të vendosë komunikim me ju. Ka gjasa të nisni një lidhje të re romantike. Përpuniqni ta mbani veten nën kontroll dhe mos i lini pas dore planet e fundvitit.

### VIRGJERESHA

Disa persona të kësaj shenje mund ta kalojnë të premtën e fundit të këtij viti të mbyllur në zyrë në përpjekjet për të përfunduar një projekt të lenë përgjysmë. Megjithatë, në mbrëmje do të planifikoni pushimet për Vitin e Ri. Një surprizë e veçantë iu pret nga partneri/partnerja juaj.

### PESHORJA

Disa Peshore mund të përballen me disa mosmarrëveshje me partnerin/partneren në lidhje me bashkëjetesën. Nëse jeni beqar, rrezikoni të jeni në qendër të një trekëndëshi dashurie. Kjo situatë do t'ju vërë shumë në veshtrësi dhe do t'ju bëjë të mendoheni gjatë.

### AKREPI

Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet të lejojnë që të pushtohen me mendime të këqija gjatë ditës së sotme. Do të ishte shumë më mirë nëse mendoni vetëm pozitivisht rreth asaj çfarë iu rrethon. Mos lejoji që anëtarë të familjes suaj të konfliktohen me njëri-tjetrin.

### SHIGJETARI

Në këtë ditë do të prekeni nga kujdesi që një mik mund të shfaqë për ju, ose mund të bashkoheni me një grup të caktuar, të cilët do t'ju ndihmojnë në shumë aspekte. Një marrëdhënie romantike mund të rezultojë shumë e çuditshme.

### BRICJAPI

Disa persona të kësaj shenje ka gjasa të dalin për shopping sot, ku do të bëni disa blerje të rëndësishme për të cilat nuk do të shpenzoni shumë. Duhet t'i përkushtoheni më shumë çështjeve personale. Bëni shumë kujdes nëse nisni një lidhje të re romantike.

### UJORI

Lajme të mira parashikohen sa i përket karrierës. Në çështjet e romancës, gjërat do ju shkojnë shumë mirë. Një horizont më i gjerë ju pret tani dhe do të shihni shumë mundësi në çdo gjë që prekni.

### PESHQIT

Do të jeni thellësisht të frymëzuar në aspektin profesional për të nisur një projekt të ri. Sa i përket dashurisë, gjërat do të vijnë duke u rregulluar hap pas hapi. Me paratë tregoni më shumë kujdes.



edhe presidenti i Federatës Italiane të Futbollit, i

**Federata italiane dënon koret raciste**

**Gravina: Inter-Napoli të ndërpritej, gjyqtari do ndëshkohet**

Futbolli italian po përballë me një problem jo të vogël duke qenë se racizmi duket se ka goditur edhe Serinë A dhe shembull për këtë është rasti i Kulibalisë në ndeshjen ndaj Interit. Ançeloti u shpreh se shpesh herë ka kërkuar ndërprerjen e ndeshjes, por asgjë nuk është marrë parasysh nga kërkesa e tij. Ndërkohë, ka folur

cili shprehet se do të merr masa në lidhje me këtë incident të ndodhur në ndeshjen Inter-Napoli. Ai tregon se pas asaj ngjarjeje, do të mendohet që edhe të ndërpritej ndeshja. "Duhet reflektuar për gjithçka

dhe tani ka ardhur momenti që të reflektojmë dhe të veprojim. Këtu ekziston një problem i rendit publik dhe si i tillë duhet të vendoset diçka, madje edhe nëse duhet ose jo të ndërpritej ndeshjet. Ne do të

marrim gjithçka që gjyqtarët kanë shkruar nga ndeshja dhe për çdo vendim që është marrë nga gjyqtari në lidhje me këto incidente, do të ketë ndëshkim për ato jo të saktat", u shpreh Gravina.

Por jo vetëm kaq, në një sfidë të tretë zikaltrit do të detyrohen të mbyllin sektorin ultra

**Koret raciste: Interi, dy ndeshje pa tifozë**

*Gjykatësi Sportiv dënon me 2 ndeshje Kulibalin e Insinjen*



Jeton Selimi

Interi do t'i paguajë shtrëngtë koret raciste të tifozëve të tij, që në sfidën e së mërkurës kundër Napolit nuk i ndaluan për asnjë çast "buuuu"-të ndaj mbrojtësit Kulibali. Qendërmbrojtësi francez, por me origjinë senegaleze, u ndëshkua me karton të kuq, por që nga minuta e parë e lojës e madje dhe kur po dilte nga fusha e lojës, "buuuu"-të e shoqëruan, duke irrituar jo pak trajnerin Ançeloti, i cili pas sfidës deklaroi se nëse herë tjetër gjyqtari nuk do ta ndalte lojën, do të mendonte vetë skuadra për ta bërë diçka të tillë. Kështu, skuadra zikaltrë do t'i luajë dy ndeshje me dyer të mbyllura, ndërsa një të tretë me sektorin ultras të mbyllur. Ky është dënimi që ka dhënë gjykatësi sportiv Gerardo Mastrandrea, për "koret me përmbajtje raciste dhe territoriale në ndeshjen kundër Napolit. Kështu Interi do të luajë pa tifozë ndeshjen e vlefshme për Kupën e Italisë kundër Beneventos më 13 janar dhe atë kundër Sasuolos me rinisjen e kampionatit më 19 janar.



Në motivacionin e Gjykatësit Sportiv, lexohet se klubi zikaltrë është ndëshkuar për "kore me përmbajtje raciste dhe ter-

ritoriale për gjatë gjithë ndeshjes kundrejt tifozëve të skuadrës kundërshtarë. Kore që e kishin origjinën nga sektori i ultrasve, por

që u dëgjuan herë pas herë dhe nga gjithë stadiumi, siç domos koret denigruese me përmbajtje raciste, të adresuara kundrejt

mbrojtësit të Napolit, Kalidou Kulibali". Por jo vetëm Interi, pasi ka pasur dhe dënime të tjera. Kështu vjen një tjetër goditje për Napolin, pas humbjes 1-0 me Interin në "San Siro". Lorenzo Insinje dhe Kalidu Kulibali, të ndëshkua me karton të kuq në këtë ndeshje, janë dënuar me nga dy ndeshje pezullim nga Gjykatësi Sportiv. Insinje është dënuar, sepse ka sharë rëndë arbitrin e ndeshjes dhe dënimi për të është maksimal, sepse ai është kapiten i skuadrës napoletane. Kurse Kulibali është dënuar për sjellje jokorrekte ndaj një kundërshtari dhe për faktin se i është drejtuar me ironi arbitrit të ndeshjes, duke e duartrokitur. Dy futbollistët e Napolit kanë humbur kështu dy ndeshjet e radhës në kampionat, me Bolonjën dhe Lacion.

**Mesi: Juventus me Ronaldon, favorit për Championsin**

Lionel Mesi foli në një rrëfim special për median italiane "TuttoSport", ku nuk la pa përmendur rivalin e tij më të madh në kohën kur ai luante të kundërshtarët e Real Madridit, Kristiano Ronaldo. Argentinasi u shpreh se Juventus është shumë më i favorizuar me CR7 në ekip për të fituar trofeun e Champions Ligës dhe ka theksuar se imungon koha kur Ronaldo ishte në Madrid. "Të jesh në të njëjtin kampionat dhe të përpiqesh të fitosh me ekipin është shumë e bukur. Kristiano ishte një lojtar i madh për La Ligën dhe Realin. Këto duela ishin shumë të bukura, por gjithmonë kam qëllimin që të fitojë ndeshjen me ekipin tim. Ronaldo i mungon çdo ekipi që do ta kishte, sepse ai shënon shumë dhe jep shumë në fushë, por Reali akoma ka një ekip të mirë dhe lojtarë të mëdhenj. Juventus është një skuadër shumë e fortë. Ishte edhe para se të transferonin Ronaldon dhe me mbërritjen e tij është shumë më e fortë tani. Më të janë kandidatë shumë të fortë për të fituar Champions-in." ka përfunduar ylli i Barçës.

**Kim Jong Un, reklamë në një skuadër angleze**

Publiciteti është shpirti i tregtisë. Motoja është një e vetme: në të mirë apo në të keq, mjafton të flasësh. Po flitet shumë këto kohë për Blajth Spartans. Kush janë? Një skuadër e National League North, kategoria e 6-të në Angli, një skuadër që kërkon të fuqizohet financiarisht me çdo mënyrë. Rrjetet sociale kanë reaguar fuqishëm, kur në stadiumin e Spartans u shfaq një baner shumë interesant: "Vizito Korenë e Veriut". Menjëherë është menduar se Kim Jong-Un ka hedhur hapin e parë për të blerë një skuadër futbollit. Në fakt, bëhet fjalë për entin zyrtar të turizmit të vendit aziatik, që nëpërmjet shtit të vet i propozon botës një panoramë të Korës së Veriut, ndryshe nga ajo që paraqet politika. Dhe tani duket se ka një farë interesi për të përfunduar në faqet e para. Kushedi nëse dikush ka prenotuar për të festuar festat e fundvitit në Kore, por qëllimi e ekspozimit mediatik është arritur plotësisht dhe skuadra angleze ka përfutuar.

**Blerja e parë e katalanasve**

**Murinjo: Është nder të jesh te Barcelona**

Klubi katalanas i Barcelonës ka zyrtarizuar blerjen e parë që është mbrojtësi i Kolumbisë, Xhejzon Murijo. Ish-lojtari i Interit është huazuar nga Valencia për në "Camp Nou" me të drejtë blerje në përfundim të këtij sezoni. Në qoftë se ai arrin të bindi ekipin e Valverde me paraqitjet e tij, atëherë Barçës do t'i duhet të shpenzojë 25 milionë euro për të marrë shërbimet e tij të plota. Ai ka thënë, gjithashtu, se do të bëjë më të



mirën për klubin dhe se do të punojë fort për të arritur objektivat e ekipit, por edhe të vetat. "Unë shpresoj të sjellë përvojën time. Është një ëndërr e bërë realitet. E di se ka lojtarë të mëdhenj në këtë skuadër dhe ajo që kam mësuar është se ata janë, gjithashtu, një familje e madhe. Që tani e tutje do të stërvitem me më të mirët dhe shpresoj që të fitoj shumë tituj këtu".- ka përfunduar mbrojtësi më i ri i Barçës.


**Ultrasi që u aksidentua nga napolitanët**

**Vdes Daniele Belardineli, neofashisti i tifogrupit "Blood&Honour"**

Një sherr masiv mes hulanëve përpara ndeshjes Inter-Napoli, rezultoi fatal për 35-vjeçarin Daniele Belardineli. Italiani është përplasur nga një minibus i tifozëve napolitanë dhe nuk ka arritur të shpëtojë. Mediat italiane raportojnë se Belardineli ishte pjesë e tifogrupit ekstremist të Vareses dhe ishte përjashtuar nga stadiumet italiane për 5 vjet si pasojë e trazirave të ndryshme. Viktima mësohet të ketë qenë edhe mik me ultrasin fashist shqiptar Landi Gjoni, me origjinë nga Lezha. Si Landi ashtu edhe Daniele kanë qenë pjesë e grupimit "Blood & Honour". Kujtojmë që tifozët e Vareses kanë binjakëzime me ata të Interit dhe shpesh herë kanë qenë të pranishëm në "San Siro".



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotualet.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Është e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë .
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Është nija që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

**VERTIKAL**

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe te Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Ishite babai i Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisi i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Eduard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samuraj.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjnjia.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.


- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filmat
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

**VERTIKAL**


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lujjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7	4	9		1	3		2
	2		6		4		
6		3	9	4	1	7	
2				8			3
			1			9	
	4		6				
3		2		8			
			3		8	1	
7	8	5	9		2		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	3	4	6	2	1	9	8	7
6	2	8	5	7	9	3	1	4
7	9	1	8	3	4	2	5	6
8	5	2	1	6	3	4	7	9
1	6	9	4	8	7	5	2	3
3	4	7	9	5	2	8	6	1
4	8	3	7	1	5	6	9	2
9	1	5	2	4	6	7	3	8
2	7	6	3	9	8	1	4	5


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*


- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoi më... vetëm mos harro se dikur isha atje për ty ... dhe ti nuk dite të më vlerësoh!!!  
 - Gjërat më të bukura në jetë nuk i shohim me sy ... por i ndjejmë me zemër!!!  
 - Kur interesohesh, nuk harron... kur kujdesesh, nuk i kthen shpinën mbrapa, kur do...nuk kërkon kohë ... kur dashuron nuk lëndon!!!  
 -Mos prisni askënd në jetën tuaj ... shkoni përpara ... dhe ata që duan, do t'ju arrijnë!!!  
 - ...Dhe vijen një ditë kur ti e kupton se "çdo gjë" ishte "asgjë" .... vetëm një zhgënjim!!!

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJES TË NUMRIT TË KALUAR**



**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**



*Thënie të mençura*

- Çdo herë që përpiqem të ndryshoj .... përfundoj të jem vetvetja!!!
- Për të fituar një luftë bërthamore, duhet të sigurohesh që nuk do të fillojnë kurrë.
- Shumë herë në jemi të mirë, sepse nuk mund të jemi të këqij
- Vetëm një sekret mund të mbajë një grua. Sekretin e moshës së saj.
- Veshët besojnë më veshitirë se sytë.
- Gjithmonë kam dashur të bëhem dikush, por duhet të isha më specifik.
- 99% e dështimeve vijnë për shkak të njerëzve që kanë si zakon të justifikohen.
- Kënaqësia e kuriozitetit tonë është një nga burimet më të mëdha të lumturisë në jetë.

